EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5715
E shtunë, 2 mars 2019
çmimi 0.40 €

Gashi: Modeli i votimit për diasporën ka dështuar, duhen ndryshime urgjente

FAQE 3

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI FAQE 4-5

PEZULLIMI I TAKSËS TË SHFRYTËZOHET PËR TË PËRFITUAR KOSOVA

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka theksuar se deri më tani taksa i ka arritur tri qëllime kryesore: E para, ka dëshmuar se Kosova është shtet sovran. E dyta, ka sensibilizuar opinionin publik, përkatësisht qytetarët e Kosovës që t'i bojkotojnë mallrat serbe dhe të konsumojnë prodhime vendore. E treta ka të bëjë me dëmin ekonomik që i shkaktohet Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka thënë se është koha që të dëgjohen këshillat e partnerëve amerikanë për pezullim të taksës. Megjithatë, ai ka thënë se nga pezullimi i taksës Kosova do të duhej të përfitonte në marrëveshjen e CEFTA-s dhe në ndaljen e veprimeve destruktive të diplomacisë serbe. Sipas tij, nëse nuk shfrytëzohet edhe kjo pak kohë, gjasat janë shumë të mëdha që me rritjen e presionit Kosova do të detyrohet ta heqë taksën pa përfituar asgjë

RAMA: KUR BASHKOHEN SHQIPTARËT NUK MUND T'I MUND ASKUSH

FAQE 3

Liderët institucionalë të Shqipërisë dhe të Kosovës kanë ftuar mërgatën shqiptare që të mobilizohet dhe të investojë në atdhe. Në Samitin e Dytë të Diasporës ata kanë vlerësuar se kontributi i diasporës për demokratizimin e Shqipërisë dhe për çlirimin e Kosovës ka qenë jashtëzakonisht i madh. Kryeministri Edi Rama ka deklaruar se kur shqiptarët bashkohen nuk mund t'i mund askush

Dialogu 'përplas' Thaçin dhe Haradinajn

FAQE 7

AKTUALE

LIKOSHANI DHE QIREZI E ZGJUAN NGA GJUMI PRISHTINËN F. 10

Sylejman KRASNIQI

LANSOHET FUSHATA VETËDIJESUESE "VENDOSE RRIPIN PËR SIGURINË TUAJ" F. 6

HOTI: PËR 11 VJET SHTET ASNJËHERË NUK KEMI QENË NË POZITË MË TË DOBËT F. 6

EKONOMI

50 STUDENTË DO TË KRYEJNË PUNË PRAKTIKE ME PAGESË NË INSTITUCIONET ENERGJETIKE F. 9

ODA AMERIKANE KUNDËRSHTON FAVORIZIMIN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE PËRMES BLERJES PA TENDER TË SHËRBIMEVE TË TYRE F. 9

SPORT

ZHDRELLA DHE BOSHNJAKU: LUAJMË PËR FITORE F. 18

TETË EKIPE ËNDËRROJNË 'TRIPLETAT' F. 19

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kosova dhe Shqipëria ftojnë votuesit e Tuzit ta votojnë Nik Gjeloshajn për kryetar

Përfaqësuesit shtetërorë dhe partiakë në Kosovë dhe Shqipëri kanë ftuar votuesit shqiptarë në Komunën e Tuzit që nesër (e diel) ta votojnë Nik Gjeloshajn për kryetar të kësaj komune. Ata kanë thënë se votimi i kandidatit të përbashkët shqiptar për kryetar të Tuzit do të ketë ndikim për të ardhmen e kësaj komune për katër vjetët e ardhshëm

Prishtinë, 1 mars - Qytetarët e Komunës së Tuzit nesër (e diel) do t'u drejtohen kutive të votimit për ta zgjedhur kryetarin e kësaj komune. Në këto zgjedhje partitë shqiptare janë bërë bashkë për ta mbështetur Nik Gjeloshajn për kryetar të Komunës së Tuzit. Kandidaturës se Gjeloshajt i kanë dhënë mbështetje edhe përfaqësuesit kryesorë shtetërorë dhe partiakë të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se shqiptarët e Malit të Zi janë përpara një çasti historik. Ai u ka bërë thirrje votuesve shqiptarë në Komunën e Tuzit që t'u përgjigjen masivisht zgjedhjeve më 3 mars, që përmes votës ta fuqizojnë pozitën e tyre, duke votuar kandidatin Gjeloshaj.

"Shqiptarët e Malit të Zi janë përpara një çasti historik. Me bashkimin e subjekteve politike shqiptare në Tuz ata po dëshmojnë pjekuri për ta udhëhequr pushtetin lokal në këtë komunë. Iu bëj thirrje të gjithë votuesve shqiptarë në Komunën e Tuzit, që t'iu përgjigjen masivisht zgjedhjeve më 3 mars, që përmes votës ta fuqizojnë pozitën e tyre", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka ftuar votuesit e Malësisë së Madhe në Mal të Zi që ta votojnë numrin 5 në zgjedhjet për Komunën e Tuzit. "Të dielën e 3 marsit, numri 5 duhet të fitojë në Komunën e Tuzit. Në zgjedhjet për komunën e Tuzit, më 3 mars, votuesit e Malësisë së Madhe do të vendosin për të ardhmen e vendit dhe familjeve të tyre për katër vjetët e ardhshëm. Është hera e parë që partitë shqiptare dalin me listë të përbashkët për t'i artikuluar interesat politike të shqiptarëve dhe për t'ia kthyer Malësisë së Madhe dhe Tuzit dinjitetin politik të munguar dekada me radhë. Votuesi malësor do të dijë ta shpalojë vullnetin e vet ditën e zgjedhjeve, duke votuar nr. 5 dhe bashkimin e partive shqiptare, pavarësisht prej ideologjive të hegjemonisë malaziase, e cila qytetarëve të Malësisë ua ka nëpërkëmbur dinjitetin duke i burgosur, duke u bërë presion asimilues, duke ua marrë të drejtën në flamur kombëtar", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se kjo është mënyra që Komuna e Tuzit të udhëhiqet ashtu sikurse duhet, të udhëhiqet shqip. "Për forumin shqiptar pas fitores së 3 marsit do të fillojnë sfidat e vërteta, që nuk do të jenë aspak të lehta por, me urtinë malësore si princip politik, besoj se do të dinë së pari ta ruajnë këtë koalicion shqiptar, si dhe të formojnë mekanizma për ta realizuar programin e tyre për mandatin katërvjeçar. Duke vendosur baza të shëndosha vendimmarrjeje në udhëheqjen e Malësisë dhe Komunës së Tuzit do të hidhen hapa të rëndësishëm drejt emancipimit politik shqiptar. Dilni dhe votoni me mendje e zemër, sepse e ardhmja shqiptare e Malësisë dhe e Tuzit është në duart tuaja", ka shkruar Kurti.

Thirrjes për votimin e Nik Gjeloshajt për kryetar të Tuzit i është bashkuar edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj. "Ftoj të gjithë shqiptarët e dashur malësorë ta shfrytëzojnë këtë shans të jashtëzakonshëm për të votuar për koalicionin e madh të partive shqiptare. Veçmas ftoj bashkatdhetarët nga kjo komunë të ndajnë pak kohë për të votuar shqip për Tuzin", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Tiranës, Erion Veliaj, ka shprehur mbështetjen për forcat shqiptare në Tuz të Malit të Zi që do të garojnë me kandidat të përbashkët për zgjedhjet lokale nën koalicionin "Malësia na bashkon". Në takimin me përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Tuz, Nik Gjeloshaj, kryetar i Partisë Alternativa Shqiptare, Nikollë Camaj, kryetar i Partisë Lidhja Demokratike e Shqiptarëve, Fadil Kajoshaj, kryetar i Partisë Unioni Demokratik Shqiptar, Veliaj ka theksuar se Nik Gjeloshaj është njeriu i duhur për ta sjellë ndryshimin e shumëpritur nga shqiptarët, por jo vetëm për Tuzin.

Meta: Krenar për kontributin e shqiptarëve në historinë e Egjiptit

Tiranë, 1 mars - Gjatë vizitës zyrtare në Egjipt, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, është takuar me përfaqësues të komunitetit të vjetër e të ri shqiptar të Egjiptit, ndër të cilët Erik Adam, nipi i patriotit tonë të shquar Thimi Mitko dhe Vera Zogu, mbesa e Mbretit Zog.

Presidenti Meta vlerësoi kontributin e spikatur që ky komunitet ka dhënë, sidomos gjatë periudhës së Rilindjes, si për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, ashtu edhe për arritjen e pavarësisë së Shqipërisë.

Duke u ndalur në miqësinë e hershme midis dy popujve, presidenti Meta nënvizoi se një rol shumë të madh luan dhe komuniteti aktual, që vazhdon në traditën më të mirë të ruajtjes dhe promovimit të miqësisë e bashkëpunimit midis dy vendeve. "Shqipëria dhe Egjipti ndajnë kulturë, histori dhe miqësi, që duhet ta forcojmë dhe zgjerojmë edhe më shumë në të ardhmen. Ju mund të luani një rol shumë të madh në këtë drejtim", tha presidenti Meta.

Ndërsa përfaqësuesit e komunitetit shqiptar shprehën gëzimin për vëmendjen e treguar nga presidenti Meta dhe shprehën besimin se shteti shqiptar do t'i mbështesë më shumë në të ardhmen për ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre kombëtar në Egjipt.

Aleatët e Bashës dorëzojnë mandatin e deputetit

TIRANË, 1 MARS - Kreu i Partisë Agrare Ambientaliste, Agron Duka dhe Nard Ndoka i PDK-së, kanë firmosur të premten dorëzimin e mandatit të deputetit, duke iu bashkuar kështu vendimit të shumicës së opozitarëve për ta djegur mandatin.

Nard Ndoka ndodhej në Bruksel dhe me të mbërritur, ashtu siç deklaroi, dorëzoi mandatin. Të njëjtën gjë bëri pak ditë më parë edhe aleati tjetër i Lulzim Bashës, Fatmir Mediu. I paqartë është qëndrimi që do ta mbajë deputetja tjetër e PD-së, Rudina Hajdari, vajza e ish-liderit të dhjetorit, Azem Hajdarit.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Është mbajtur në Tiranë Samiti i Dytë i Diasporës

Rama: Kur bashkohen shqiptarët nuk mund t'i mund askush

Liderët institucionalë të Shqipërisë dhe të Kosovës kanë ftuar mërgatën shqiptare që të mobilizohet dhe të investojë në atdhe. Në Samitin e Dytë të Diasporës ata kanë vlerësuar se kontributi i diasporës për demokratizimin e Shqipërisë dhe për çlirimin e Kosovës ka qenë jashtëzakonisht i madh. Kryeministri Edi Rama ka deklaruar se kur shqiptarët bashkohen nuk mund t'i mund askush

"Epoka e re"

PRISHTINË, 1 MARS - Kontributi i diasporës shqiptare për demokratizimin e Shqipërisë dhe për çlirimin e Kosovës është vlerësuar lart në Samitin e Dytë të Diasporës i cili po mbahet në Tiranë. Liderët institucionalë të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, i kanë ftuar shqiptarët t'i bashkojnë forcat kudo që ndodhen në shërbim të atdheut të tyre.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili ka folur për zhvillimet që kanë ndodhur në harkun kohor mes samitit të parë dhe këtij të tanishmit, ka thënë se kur shqiptarët bashkohen nuk mund t'i mund askush. "Kudo ku shqiptarët bashkohen janë më të mirët dhe fitojnë. Historia e ka treguar, nuk dua të sjell këtu as Gjergj Fishtën, as Faik Konicën, as Fan Nolin, por edhe e sotmja na tregon, se armiku më i madh i shqiptarëve janë shqiptarët. Ne kudo ku bashkohemi nuk na mund dot askush. Ndaj shqiptarëve në Tuz iu them bashkohuni", ka thënë Rama.

Ai ka deklaruar se tani shqiptarët janë më mirë se që kanë qenë më herët. "Jo vetëm se shqiptarët në Shqipëri janë më mirë sot se ç'ishin në kohën e samitit të parë, por ajo që konsiderohej si e pamundur për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut sot është realitet. Brenda këtij harku kohor në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut flitet shqip. Ne jemi të interesuar që ai shtet të ekzistojë, të përparojë drejt integrimeve euroatlantike dhe shqiptarët atje të jenë më mirë sot dhe në të ardhmen sesa ç'kanë qenë dje. Pa shqiptarët nuk do të kishte Maqedoni të Veriut, aq më pak Maqedoni të Veriut në NATO apo BE", është shprehur Rama.

Ai i ka ftuar shqiptarët në Tuz të Malit të Zi të bashkohen dhe t'i lënë mënjanë armiqësitë e kota dhe të panevojshme me njëri-tjetrin, për të fituar dhe për të qeverisur në komunën e parë me shqiptarë.

Edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ftuar shqiptarët në Tuz që të bashkohen në zgjedhjet e të dielës për ta qeverisur këtë komunë. Presidenti Thaçi ka thënë se kontributi i diasporës shqiptare ka qenë i jashtëzakonshëm edhe për avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi dhe Luginë të Preshevës. "Mbijetesa e kombit tonë nuk mund të paramendohet pa kontributin e bashkatdhetarëve tanë. Lëvizja më e rëndësishme kulturore shqiptare, Rilindja Kombëtare, rrënjët i ka në diasporën shqiptare. Pa djersën, organizimin dhe mundin e diasporës Kosova nuk do ta mbijetonte periudhën më të vështirë të saj, në dekadën e fundit të shekullit njëzet. Afirmimi dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës nuk do ta arrinte sensibilizimin pa protestat dhe rezistencën sistematike të diasporës sonë në kryeqytetet e demokracisë botërore. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk do të ishte aq e lavdishme pa kontributin me armë në duar dhe financiar të diasporës shqiptare. Kosova u është përjetësisht mirënjohëse", ka vlerësuar Thaçi.

Kurse lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, në këtë samit ka bërë thirrje për mobilizim të mërgatës shqiptare kudo për të zbarkuar në atdhe. "Gjergj Kastrioti u mobilizua dhe u zbarkua këtu. Rilindja shqiptare veproi në Perëndim e Lindje, por të tërë energjinë e vuri në shërbim të vendit dhe të atdheut. Pavarësia e Shqipërisë, Ushtria Çlirimtare u financua, u ushqye dhe mobilizua pikërisht nga mërgata. Të zbarkojmë me njerëz të mençur, inxhinierë, ekonomistë, juristë, doktorë të mirë të të gjitha fushave, për këtë më së shumti nevojë ka atdheu ynë, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Të gjitha mundësitë janë që t'i materializojmë", ka thënë Ahmeti.

Për të dytin vit me radhë Samiti i Diasporës të premten ka sjellë në Tiranë një numër të madh të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë dhe të Kosovës. Samiti i Diasporës do të zgjasë deri më 2 mars.

Gashi: Modeli i votimit për diasporën ka dështuar, duhen ndryshime urgjente

TIRANË, 1 MARS (ER) - Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka marrë pjesë të premten në punimet e Samitit të Dytë për Diasporën organizuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Në panelin për Votën e Diasporës si e drejtë politike, ministri Gashi ka theksuar se sistemi i tashëm i pjesëmarrjes së diasporës në zgjedhjet në Kosovë mund të konsiderohet i dështuar andaj, sipas tij, ndryshime sa më të shpejta duhet të ndërmerren nga Qeveria e Kosovës. Në këtë kontekst, Gashi ka potencuar se si shtet "llogarisim që në diasporë kemi rreth 700 mijë shtetas të Kosovës, po aq sa edhe kemi votues në Kosovë" mirëpo, sipas tij, përqindja e pjesëmarrjes së diasporës është pak më shumë se 1 për qind. "Kjo mund të riparohet duke e përdorur ligjin ekzistues, por me ndryshimin e modelit të zgjedhjeve apo me ndryshimet në Ligjit e Zgjedhjeve dhe Kushtetutës në relacion me zgjedhje. Gjatë marsit do t'i fillojmë konsultat me partitë parlamentare politike në Kosovë, më pas edhe debate publike të ngjashme me ato për Ligjin e diasporës, që t'u ofrojmë partive politike, Qeverisë dhe Kuvendit, një platformë të përbashkët se si në të ardhmen të organizohet pjesëmarrja e diasporës në

jetën politike në Kosovë", ka thënë Gashi.

Ky përkushtim reflektohet edhe me Ligjin dhe Strategjinë e re të diasporës të cilët pritet të miratohen së shpejti.

Flet për "Epokën e re", Valon Murati

Pezullimi i taksës të shfrytëz

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka theksuar se deri më tani taksa i ka arritur tri qëllime kryesore: E para, ka dëshmuar se Kosova është shtet sovran. E dyta, ka sensibilizuar opinionin publik, përkatësisht qytetarët e Kosovës që t'i bojkotojnë mallrat serbe dhe të konsumojnë prodhime vendore. E treta ka të bëjë me dëmin ekonomik që i shkaktohet Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka thënë se është koha që të dëgjohen këshillat e partnerëve amerikanë për pezullim të taksës. Megjithatë, ai ka thënë se nga pezullimi i taksës Kosova do të duhej të përfitonte në marrëveshjen e CEFTA-s dhe në ndaljen e veprimeve destruktive të diplomacisë serbe. Sipas tij, nëse nuk shfrytëzohet edhe kjo pak kohë, gjasat janë shumë të mëdha që me rritjen e presionit Kosova do të detyrohet që ta heqë taksën pa përfituar asgjë

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 MARS -

"Epoka e re": *Z. Murati, sërish zyrtarët e lartë amerikanë, gjatë vizitës në Prishtinë, kanë qartësuar sugjerimin e tyre për pezullimin e taksës. Si e keni parë vizitën e tyre?*

Murati: Në radhë të parë më duhet të theksoj se vendosja e taksës ndaj prodhimeve serbe ishte një hap i duhur i Qeverisë së Kosovës. Ne duhet të ndërtojmë një politikë të reciprocitetit me Serbinë në të gjitha fushat. Kjo duhet të shkojë kështu si princip deri në zgjidhjen e çështjes shqiptaro-serbe, apo atë që po quhet marrëveshje finale. Në këtë drejtim kemi qenë të vonuar. Sidoqoftë, si LB kemi theksuar që nga fillimi se vendosja e drejtë e taksës nuk do të duhej të ndikonte në zbehjen e marrëdhënieve të Kosovës me aleatët e saj, ShBA-në dhe BE-në, si dhe nuk do të duhej ta dëmtonte marrëveshjen finale me Serbinë. Asaj që i jam frikësuar në kohën kur është vendosur taksa, dhe tash po del më qartë, është se vendosja e saj nuk është bërë pas një analize serioze e, për më tepër, nuk është trajtuar rruga dalëse. Për krejt diçka tjetër u tha se u vendos taksa fillimisht, e për krejt diçka tjetër po mbrohet mospezullimi i saj sot. Kështu u tha se ajo po vendoset si reagim ndaj veprimeve destruktive të Serbisë në Interpol, si reagim ndaj ofensivës së saj në atë që po quhet proces i çnjohjeve të Kosovës si dhe si kundërpeshë në pengesat që iu bëhen prodhuesve të Kosovës në Serbi dhe të qarkullimit të lirë të njerëzve. Në këtë periudhën fillestare patëm edhe garë se kush e ka propozuar taksën. Ndërkohë kryeministri Haradinaj filloi ta lidhë heqjen e taksës me dialogun, rezultatet e tij, njohjen e, tash së fundmi, me paqartësitë që, sipas tij, do të sjellë vetë dialogu, sidomos në planin e idesë së ndryshimit të kufijve. Ky qëndrim i kryeministrit vjen në kohën kur partnerët qeverisës, së bashku me PSD-në, kanë miratuar rezolutën për dialogun, ekipin e dialogut dhe tanimë kanë paraqitur një draft-platformë për bisedimet. Në këtë drejtim lidhja e taksës me dialogun nuk ka kuptim, sepse pse ke hartuar atëherë

ohet për të përfituar Kosova

gjithë ato dokumente edhe ashtu super të ngurta sa i përket çështjes së integritetit territorial dhe pse ke krijuar ekipin e negociatave. Duket se në këtë situatë askush nuk i beson askujt, e sidomos jo se çfarë do të ndodhë në procesin e dialogut. Kjo situatë ka krijuar një kaos qëndrimesh të cilat lidhen edhe me matematikat e brendshme të mbijetesës së koalicionit qeveritar. Mirëpo duke qenë se administrata amerikane ka përcaktuar vitin 2019 vit të marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke e bërë të qartë edhe përmes letrës së presidentit Tramp dërguar presidentit Thaçi përkrahjen për pavarësinë e Kosovës dhe për dialogun në mes të dy vendeve, kjo administratë është e interesuar që ky dialog të vazhdojë. Sado që është e padrejtë nga ana e Serbisë që dialogun e ka lidhur me çështjen e taksës, është fakt se dialogu është ndërprerë. Rrjedhimisht kohën e fundit është shtuar presioni i ShBA-së mbi Kosovën që ta pezullojë përkohësisht taksën. Edhe vizita e fundit e përfaqësuesve të Këshillit të Sigurisë të administratës amerikane ishte në këtë funksion. Tashmë është e qartë se ShBA-ja është e interesuar që Kosova ta pezullojë taksën si hap drejt rikthimit në tryezën e bisedimeve. Ajo që doli në publik dje ishte se ata janë të interesuar që Kosova, përveç pezullimit, të ketë edhe kërkesa përmes të cilave do të ndaleshin veprimet destruktive të Serbisë në planin e jashtëm si dhe do të kishte një raport të barabartë në planin e tregtisë së lirë dhe të lëvizjes së lirë të njerëzve.

"Epoka e re": Cilat janë veprimet që duhet t'i ndërmarrin institucionet e Kosovës pas këtyre sugjerimeve?

Murati: Deri më tani besoj se taksa i ka arritur tri qëllime kryesore. E para, ka dëshmuar se Kosova është shtet sovran që në raport me Serbinë guxon dhe merr masa reciprociteti. Pra, ka dëshmuar sovranitet të qartë në raport me Serbinë. E dyta, kjo masë ka sensibilizuar opinionin publik, përkatësisht qytetarët e Kosovës, që t'i bojkotojnë mallrat serbe dhe të konsumojnë prodhime vendore. Ka krijuar rrjedhimisht një ambient më të mirë për prodhuesit vendorë, i cili në të ardhmen do t'i ketë efektet e duhura. Gjithashtu, ndjenja e bojkotit të mallrave serbe do të mbetet pa marrë parasysh se çfarë ndodh me taksën. E fundit ka të bëjë me dëmin ekonomik që i shkaktohet Serbisë, i cili, ndonëse nuk ka ndonjë analizë të duhur, nuk mbetet pa efekte, së paku në atë pjesë të ekonomisë serbe e cila është e lidhur me eksportet në Kosovë. Kjo situatë, ndonëse ende pa statistika të qarta, ka bërë që prodhimi vendor të rritet. Thashë se shumica e këtyre efekteve do të vazhdojnë të ndihen, sidomos në të ardhmen. Megjithatë, tani është çasti që të dëgjohen këshillat e partnerëve tanë, e sidomos amerikanëve, për pezullim të taksës. Gjithashtu, do të duhej të shfrytëzohej gatishmëria e amerikanëve dhe e BE-së që Kosova nga ky pezullim të dalë me përfitime si në marrëveshjen e CEFTA-s, po ashtu edhe në ndaljen e veprimeve destruktive të diplomacisë serbe. Nëse nuk shfrytëzohet edhe kjo pak kohë që kemi, gjasat janë shumë të mëdha që me rritjen e presionit do të detyrohemi ta heqim taksën pa përfituar asgjë.

"Epoka e re": *Dy zyrtarët e lartë amerikanë në takimet me liderët institucionalë të Kosovës kanë përmendur edhe hapat e tjerë që mund t'i ndërmarrë ShBA-ja ndaj Kosovës, duke përfshirë edhe largimin e trupave nga Kosova. Sa shqetësuese mund të jetë kjo?*

Murati: Unë shqetësohem për acarimin e marrëdhënieve dhe faktit se qeveria amerikane mund të marrë ndonjë masë sanksioni për qeverinë tonë, por nuk shqetësohem për fatin e këtyre marrëdhënieve në planin afatgjatë dhe strategjik. Nuk ka dyshim se Kosova, edhe tërë faktori shqiptar në Ballkan, janë partnerë strategjikë të ShBA-së dhe nuk ka dyshim se ShBA-ja ka një rol të jashtëzakonshëm për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës përmes ndihmës që i ka dhënë luftës çlirimtare të popullit shqiptar. Andaj, duke qenë kështu, kjo marrëdhënie mund vetëm të zbehet në planin ndërqeveritar, por asnjëherë në atë ndërshtetëror apo në mes të dy popujve. Më parë mund të ndodhë të largohen qeveritë e Kosovës sesa të dëmtohen seriozisht marrëdhëniet në mes të dy vendeve. Në këtë drejtim, besoj se, nëse është përmendur çështja e largimit të trupave amerikane dhe bazës në Bondstill, më shumë është përmendur në kontekstin që, nëse Kosova e sheh të panevojshme miqësinë me ShBA-në, ata mund ta trajtojnë edhe marrjen e atij hapi në të ardhmen. Por, nuk besoj se ajo do të ndodhë. Për më tepër, ShBA-ja dhe NATO po duan ta përforcojnë praninë e tyre ushtarake në trevat shqiptare përmes ndërtimit të bazës ajrore të NATO-s në Kuçovë. Është e qartë se faktori shqiptar, si faktori më pro-amerikan në Ballkan, njëkohësisht është edhe digë për depërtimin e interesave ruse në Ballkan, e sidomos në Mesdhe. Madje në funksion të kësaj gjeostrategjie jam i bindur se amerikanët edhe kanë lejuar hapjen e çështjes së kufijve në mënyrë që përmes ripërcaktimit të kufijve (pjesa shqiptare e Kosovës Lindore do të duhej t'i bashkohej Kosovës dhe tri komunat serbe në veri pa shtatë fshatrat shqiptare t'i bashkohen Serbisë), Kosova të shndërrohet në një shtet funksional dhe pa mundësi të ndikimit destabilizues të interesave ruse. Pra, ta përsëris, nuk shoh ndonjë rrezik të largimit amerikan nga Kosova, apo të dëmtimit të raporteve tona në planin afatgjatë. Por, ne duhet të mendojmë sa po e dëmtojmë veten duke i vendosur gurë dhe dru rrugës procesit të bisedimeve me Serbinë. Vazhdimi i status-quos më së shumti do të dëmtojë Kosovën dhe qytetarët e saj.

"Epoka e re": *Nëse Kosova refuzon t'i dëgjojë këshillat amerikane, a rrezikon që nga bashkësia ndërkombëtare të shihet si palë destruktive në dialog?*

Murati: Ende nuk kemi arritur në atë pikë, ndonëse Serbia ka kohë që përpiqet ta luajë rolin e të mirit në këtë proces. Më shumë sesa të brengosemi se si do të na shohin ne në raport me dialogun, ne duhet të kuptojmë se kemi nevojë për të në mënyrë që t'i zgjidhim problemet me Serbinë. Ne duhet ta kuptojmë se raste të tilla, kur administrata amerikane është e interesuar t'i zgjidhë problemet në mes të Kosovës dhe Serbisë edhe përmes përkushtimit personal të presidentit Tramp, nuk vijnë shpesh. Nëse ne lejojmë të na ikë ky rast, do ta vuajmë më së shumti. Serbia me ndonjë potez të vogël (siç është heqja e Kosovës nga kushtetuta e saj) mund të ecë përpara me integrimet evropiane, ndërsa ne të barrikaduar në idenë e mosndryshimit të kufijve, në Kushtetutën që ua garanton veton serbëve dhe asociacionin që e kemi obligim ligjor, do të mbesim jo vetëm larg integrimeve euroatlantike por, para së gjithash, një shtet jofunksional e me pak mundësi të merret me çështje jetike të qytetarëve tanë siç janë ekonomia, arsimi dhe shëndetësia, lufta kundër korrupsionit dhe sundimi i ligjit. Do të vazhdojmë kështu të sillemi në rrethin vicioz të "temave të mëdha" e të jofunksionalitetit të shtetit e me vështirësi të shtrirjes të sovranitetit real në veri të vendit. Në anën tjetër, ne rrezikojmë që popullsia shqiptare nga Kosova Lindore të na dëbohet gradualisht nga vatrat e veta për shkak të presionit dhe mungesës së perspektivës.

"Epoka e re": *Cila duhet të jetë rruga për të dalë nga kjo situatë, në qoftë se nuk arrihet një konsensus për pezullimin e taksës?*

Murati: Në situatën e dhënë nuk ka shumë rrugë alternative. E para është pezullimi i taksës. E dyta është krijimi i një qeverie uniteti, të cilën ne si LB e kemi kërkuar që para se të formohej kjo qeveri. Një qeveri e tillë do të kishte mandat të kufizuar, me shumë gjasa ta përfundojë marrëveshjen me Serbinë dhe, ndoshta, edhe ta realizojë reformën zgjedhore. Dhe varianti i tretë, të cilën askush nuk po e dëshiron, së paku jo në deklarata publike, është ideja e zgjedhjeve të reja. Nuk kam dyshim se në të gjitha variantet Kosova do të arrijë të gjejë forcë për t'i rehabilituar shumë shpejt raportet me SHBA-në, domosdo edhe me BE-në, sepse ne nuk e kemi luksin e raporteve të tensionuara me ta.

Hoti: Në 11 vjet shtet, asnjëherë nuk kemi qenë në pozitë më të dobët

Prishtinë, 1 mars (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka vlerësuar se qeveria aktuale e ka dërguar Kosovën në një situatë ku janë vënë në pikëpyetje marrëdhëniet me aleaten e saj kryesore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas shefit të grupit parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, rrezikimi i marrëdhënieve të shtetit të Kosovës me ShBA-në dëshmohet edhe me faktin se për herë të parë në historinë e Kosovës, sipas tij, i mohohet vizita në ShBA, një lideri institucional të Kosovës, në këtë rast kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. "Që 11 vjet shtet asnjëherë nuk kemi qenë në pozitë më të dobët si në politikën e brendshme, po ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Nuk kemi parë asnjëherë degradim më të madh institucional gjatë gjithë këtyre viteve dhe humbje të plotë të besueshmërisë së qytetarëve ndaj lidershipit të vendit", ka deklaruar Hoti në një konferencë për media të premten.

Hoti ka kritikuar edhe presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, për, siç ka thënë, lobimin e tij për ndryshim të kufijve të shtetit të Kosovës në vend se të lobonte për njohje të reja nga shtete që s'e kanë njohur ende pavarësinë e këtij shteti. Për të dalë nga kjo situatë, sipas tij, ekziston vetëm opsioni i zgjedhjeve si dhe ardhja e një qeverie me legjitimitet të plotë, e cila do ta udhëhiqte edhe procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian në Bruksel.

Në Kirurgji Torakale një profesor i huaj po aplikon një metodë të re të operacioneve

EPOKA E RE — Faton DËRMAKU

Prishtinë, 1 mars - Në Qendrën Klinike Universitare po qëndron prof. dr. Diego Gonzalez Rivas, i cili po aplikon metodën më të re të operimeve me një portë, një ndërhyrje në kraharor te resekcionet pulmonare për sëmundjet kirurgjike të mushkërive. Ai po viziton Kosovën si pjesë e një turi disaditorë në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në kuadër të programit të avancuar "Uniportal Port", bashkë me ekipin mjekësor nga Klinika e Kirurgjisë Torokale, do t'i kryejë tri operime. Duke folur për metodën e operimit Wats Uniportal, Rivas ka pohuar se kjo ndërhyrje kirurgjike shoqërohet me pak dhimbje dhe pacienti kurohet shumë shpejt. "Ne do të bëjmë një operim me një vrimë të vogël, meterokoskop, do të bëjmë një lob të poshtëm të majtë dhe një lob lart në të djathtë, i cili shkakton shumë pak gjakderdhje, shumë pak dhimbje dhe pacienti shumë shpejt shërohet e lirohet në shtëpi", ka thënë Rivas.

Aplikimi i kësaj metode ka për synim ta ngrehë standardin profesional të punës në klinikat e QKUK-së, respektivisht që kirurgët e Kirurgjisë Torokale t'i zotërojnë procedurat më moderne të trajtimit të sëmundjeve kirurgjike.

Drejtori i Klinikës së Kirurgjisë Torokale, Saudin Maliqi, ka theksuar se ardhja e Rivas në Kosovë është historike për Qendrën Klinike Universitare. "Ardhja e tyre është moment historik për ne, është një ndodhi shumë e madhe. Ardhja e këtij ekipi është e aranzhuar dhe ne kemi aplikuar para një viti. Kemi bërë shumë përpjekje për ta sjellë atë në Kosovë", ka deklaruar Maliqi.

Rivas mbajti një ligjëratë të enjten në Qendrën Kombëtare të Telemjekësisë, ku ishin të lidhura edhe qendrat rajonale, Shkupi dhe Tirana.

Burgim të përjetshëm Pjetër Nrecajt që vrau gruan dhe vajzën 9 vjeçe

Prishtinë, 1 mars (ER) - Gjykata e Apelit e ka dënuar me burgim të përjetshëm Pjetër Nrecajn i cili vitin e kaluar vrau gruan dhe vajzën e vet nëntëvjeçare. Apeli ka vlerësuar se Gjykata e Shkallës së Parë nuk i kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese. "Shqiptimi i dënimit unik prej 24 vjetëve burgim nuk është adekuat me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, për faktin se janë shkaktuar pasoja tepër të rënda me rastin e privimit nga jeta të bashkëshortes së tij V. N dhe vajzës së tij K. N., e që ka mundur të shkaktohen pasoja edhe më të rënda", thuhet në njoftimin e Gjykatës së Apelit.

Në aktvendimin e Gjykatës së Apelit më tej thuhet se Pjetër Nrecaj në mënyrë të vazhdueshme ka pasur sjellje të këqija ndaj bashkëshortes, duke ushtruar dhunë si dhe vepra penale është kryer në prani të fëmijëve dhe vëllezërve të viktimës, e ku pasojat kanë mundur të jenë edhe më të rënda.

Vitin e kaluar Gjykata Themelore në Gjakovë e shpalli fajtor Pjetër Nrecajn për vrasje të dyfishtë. Ai ishte dënuar me 23 vjet burgim për vrasje dhe dy vjet për armëmbajtje pa leje. Pjetër Nrecaj kishte vrarë gruan e vet, 40-vjeçaren Valbona Nrecaj dhe vajzën e nëntëvjeçare K. N., më 7 gusht të vitit të kaluar.

Dialogu 'përplas' Thaçin dhe Haradinajn

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, derisa ka folur në Samitin e Diasporës në Tiranë, ka kritikuar kryeministrin Ramush Haradinaj, duke thënë se ideja e tij për konferencë ndërkombëtare për dialogun Kosovë - Serbi do t'i mundësonte Rusisë që të ndihmonte në këtë proces. Sipas tij, Haradinaj tashmë ka hequr dorë nga një ide e tillë pas këshillave që i ka dhënë Thaçi. Por, kryeministri Haradinaj ka thënë të premten në Prishtinë se presidenti Thaçi i ka bërë dëme të mëdha vendit me idetë e tij lidhur me dialogun dhe me avancimet për ndarje të Kosovës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 MARS - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj nuk po arrijnë të gjejnë gjuhë të përbashkët sa i përket ecurisë së dialogut Kosovë - Serbi. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë të premten se presidenti Hashim Thaçi i ka shkaktuar dëme të mëdha Kosovës me diskutimet për dialogun. "Presidenti i ka bërë dëme të mëdha vendit me idetë e tij lidhur me dialogun dhe me avancimet për ndarje të Kosovës. Pra, diskutimet e tij e kanë sjellë Kosovën ku është sot", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.
Ai ka përjashtuar mundësinë që Shtetet e Bashkuara ta largojnë praninë e tyre ushtarake nga Kosova si pasojë e mospranimit të rekomandimit amerikan për heqje të taksës prej 100 përqindësh në produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. "Amerika është garantuese e sigurisë dhe paqes në gjithë globin. Vendimet që janë folur si kërcënim për Bondsteelin janë, ndoshta, të hershme ose të avancuara për shkak se një vendim i tillë mund të merret, por jo në rrethana ose lidhur me taksën. Ndërsa të gjitha argumentet për të cilat është vendosur taksa, agresiviteti i Serbisë në planin e jashtëm, përpjekjet për destabilizim në planin e brendshëm dhe vonesa, pra për njohje që i shkakton dëm Kosovës, ekzistojnë. Taksa mbetet deri në njohje të Kosovës", ka shtuar Haradinaj.
Kryeministri ka vlerësuar se "nuk është mirë që të vrapohet për t'u treguar proamerikan duke e hequr taksën ndaj Serbisë" pasi kjo, sipas tij, nuk i ndihmon shumë Kosovës.
Për dialogun ka folur të premten në Tiranë edhe presidenti Hashim Thaçi, i cili ka marrë pjesë në Samitin e Dytë të Diasporës. Gjatë fjalimit të tij, presidenti është kujdesur që ta godasë edhe kundërshtarin më të madh të idesë për korrigjim të kufijve, Ramush Haradinajn, duke thënë se ideja e tij për konferencë ndërkombëtare do t'i mundësonte Rusisë që të participonte. Sipas tij, Haradinaj tashmë ka hequr dorë nga një ide e tillë pas këshillave që i ka dhënë vetë Thaçi. "Sot natyrisht se ka ide të ndryshme. Nuk do ta lejojmë organizimin e ndonjë konference ndërkombëtare ku participon edhe Rusia. Kosova participon vetëm në procese ku janë BE-ja dhe ShBA-ja. Edhe për propozuesit për konferencë ndërkombëtarë e kemi këshilluar të heqë dorë dhe ka hequr dorë", ka shtuar ai. Ai ka përmendur në disa raste idenë e korrigjimit të kufirit si rezultat i marrëveshjes me Serbinë. Por, ideja e korrigjimit, sipas Thaçit, nuk është e njëjtë me idenë e shkëmbimit të territorit apo ndarjes së Kosovës. "Shkëmbimi i territoreve nuk do të ndodhë. Shkëmbimi është pazar dhe nuk do të lejojmë pazare me territore. Ndarja e Kosovës, pa shkelur mbi trupin tim, nuk do të mund të cenojë as një milimetër të territorit të Kosovës. Askush nuk do të mund ta cenojë 'Trepçën', Ujmanin, as edhe një pjesë të territorit të Kosovës", ka deklaruar Thaçi në Tiranë.
Pavarësisht prej rekomandimit amerikan, kryeministri Ramush Haradinaj është deklaruar vazhdimisht kundër heqjes së taksës prej 100 përqindësh për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina. Haradinajt iu kërkua heqja e taksës edhe në takimin e përbashkët që kishte me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçin, dhe me dy zyrtarët e lartë amerikanë, zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë Kombëtare për Evropën, John Erathin dhe drejtorin për Çështje Evropiane, Brad Berkley.
Shtetet e Bashkuara kanë përsëritur disa herë se mospezullimi taksës së vënë në importet e Serbisë dhe Bosnjës përbën qëndrim kundër interesave të ShBA-së.

Veseli: Duhet mençuri për ta mbajtur Bondsteelin në Kosovë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, nuk ka dashur të komentojë shumë të premten sa iu takon kërkesave amerikane që i sollën në Prishtinë dy zyrtarët e lartë amerikanë, zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë Kombëtare për Evropën, John Erath dhe drejtori për Çështjet Evropiane, Brad Berkley.
Dy zyrtarët amerikanë, Earth dhe Berkley, patën takime me liderët institucionalë dhe opozitën në Kosovë gjatë kësaj javë. Pas këtyre takimeve mediat raportuan se zyrtarët amerikanë kanë përmendur edhe largimin e bazës ushtarake amerikane, Bondsteel, nga Kosova. Mirëpo Veseli nuk beson se Kosova do të përballet me largim të pranisë ushtarake amerikane. "Do të qëndrojë baza Bondsteel, por ne duhet të jemi më të mençur për ta mbajtur ketë bazë dhe ta promovojmë këtë prani amerikane, me biznese amerikane. Në vend se të mendojmë, ne tani, si ta kryejmë procesin e dialogut, si të marrim ulëse në OKB pa e cenuar territorin e Kosovës e të mendojmë për aspekte ekonomike që investitorë amerikanë e gjermanë të vijnë në Kosovë, ne po merremi ende me vetveten", ka deklaruar Veseli në një konferencë për media pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Lansohet fushata vetëdijesuese "Vendose rripin për sigurinë tuaj"

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Këshilli për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, lansuan të premten fushatën vetëdijesuese "Vendose rripin, për sigurinë tuaj". Nënkoloneli Jeton Rexhepi ka thënë se qytetarët duhet ta vendosin rripin në çdo rast sepse i siguron shoferët, mirëpo kjo gjë i lehtëson punën edhe policisë. Ndërsa drejtori i Këshillit për Siguri në Rrugë, Fejzullah Mustafa, ka thënë se do të zhvillohen edhe fushata të tjera në mënyrë që të vetëdijesohen qytetarët si dhe të parandalohen aksidentet në komunikacion. Kjo fushatë ka për qëllim vetëdijesimin e pjesëmarrësve në trafikun rrugor lidhur me përdorimin e rripit të sigurisë.

50 STUDENTË DO TË KRYEJNË PUNË PRAKTIKE ME PAGESË NË INSTITUCIONET ENERGJETIKE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 MARS - Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike do të kenë mundësi të kryejnë punë praktike me pagesë në institucionet e sektorit energjetik të cilat i përfaqëson Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, së bashku me rektorin e Universitetit të Prishtinës, prof. Marjan Dema, kanë nënshkruar të premten memorandumin e bashkëpunimit që u mundëson 50 studentëve të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike ta kryejnë punën praktike tremujore me pagesë në Korporatën Energjetike të Kosovës "KEK SH.A", Operatori, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu "KOSTT SH.A", Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike "KESCO SH.A" dhe në Kompaninë për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike në Kosovë "KEDS SH.A".

Gjatë fjalimit para nënshkrimit të memorandumit, ministri Lluka ka falënderuar rektorin Dema i cili i është përgjigjur kërkesës për nënshkrim të memorandumit brenda ditës, duke theksuar se kjo nismë do t'i përgatisë kuadrot e reja për investimet të cilat vijnë në sektorin e energjisë. "Me strategjinë e re të sektorit energjetik ne planifikojmë të investojmë tre miliardë euro në këtë sektor dhe kjo do të kërkojë kuadro të reja dhe të përgatitura. Kjo marrëveshje është një kontribut i madh në këtë aspekt", është shprehur Lluka.

Ndërsa rektori Marjan Dema ka falënderuar ministrin Lluka për iniciativën, duke pohuar se kjo iniciativë do t'i ndihmojë studentët të fitojnë njohuri të reja dhe të përgatiten për tregun e punës. "Kjo iniciativë ka ardhur nga ministri Lluka dhe e falënderojmë për këtë. Ne duhet të përgatisim kuadro të cilat janë të gatshme të përballen me tregun e punës dhe kjo marrëveshje është një prej mënyrave. Kjo është një mundësi e mirë për studentët e sektorit të energjetikës që të përgatiten dhe t'i ndihmojnë këtij sektori", ka deklaruar rektori Dema.

Përveç punës praktike, studentët do të kenë mundësi që nën angazhimin e personelit të UP-së të zhvillojnë aktivitete shkencore dhe profesionale, t'i përdorin pajisjet dhe laboratorët e UP-së për aktivitete si dhe shfrytëzimin e sallave të MZhE-së dhe UP-së për organizim e trajnimeve dhe konferencave të ndryshme, të gjitha këto me synim të promovimit dhe masivizimit të edukimit në fushën e energjisë.

FMN-ja vazhdon ta mbështesë ATK-në

Prishtinë, 1 mars (ER) - Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka mbajtur takim me përfaqësuesit e Zyrës së Fondit Monetar Ndërkombëtar në Kosovë, Ruud Vermeulen dhe Selim Thaçi, të cilët e uruan drejtorin Murtezaj për pozitën e re.

Në takim u diskutua për bashkëpunimin që do të zhvillohet përgjatë këtij viti, për të cilin përfaqësuesit nga FMN-ja thanë se do të vazhdojnë ta mbështesin ATK-në për zhvillimin dhe avancimin e fushave me rëndësi, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

Ndrësa drejtori Murtezaj ka falënderuar përfaqësuesit e FMN-së për mbështetjen e deritanishme dhe ka potencuar nevojën për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Ai ka vlerësuar se ATK-ja ka nevojë t'i rrisë kapacitetet në disa fusha të caktuara, të cilat kanë rol kyç për realizimin e objektivave të përcaktuara.

Kujtojmë se FMN-ja ka përkrahur ATK-në në të gjitha fazat e zhvillimit të saj.

ODA AMERIKANE KUNDËRSHTON FAVORIZIMIN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE PËRMES BLERJES PA TENDER TË SHËRBIMEVE TË TYRE

EPOKA E RE — A. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 MARS - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shprehur shqetësimet lidhur me favorizimin e ndërmarrjeve publike përmes aplikimit të gabueshëm të dispozitave për blerjet "brenda shtëpisë" përmes të cilave autoritetet publike blejnë shërbime nga ndërmarrjet publike në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, Ligjin e Prokurimit Publik, si dhe Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. "Kjo praktikë e gabueshme, që cenon trajtimin e barabartë të ndërmarrjeve publike dhe private, buron nga një interpretim jo i drejtë i bërë nga ana e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik lidhur me nenin 9.4 të Ligjit mbi Prokurimin Publik, i cili parasheh që, nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar që lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik", është thënë në komunikatën e Odës Amerikane.

Megjithatë, Oda Amerikane thekson se ndërmarrjet publike në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si "autoritete publike", prandaj praktika e blerjes së shërbimeve të tyre nga ana e autoriteteve kontraktuese përmes dispozitave të "prokurimit brenda shtëpisë" duhet të ndërpritet meqë cenon konkurrencën e drejtë.

Sipas Odës Amerikane, favorizimi i ndërmarrjeve publike sipas kushteve të sipërcekura është në kundërshtim me parimet thelbësore të ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë, të rregulluar me nenin 10 dhe 119 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. "Gjithashtu, Neni 13 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike përmban dispozita të qarta, sipas të cilave, të gjitha ndërmarrjet publike, pa asnjë përjashtim, u nënshtrohen ligjeve, rregulloreve dhe akteve nënligjore të cilat i rregullojnë shoqëritë tregtare në pronësi private. Oda Ekonomike Amerikane u kërkon të gjitha autoriteteve publike t'i ndërpresin praktikat e gabuara të favorizimit të ndërmarrjeve publike, duke rikujtuar se autoritetet publike kanë përgjegjësi për ofrimin e mjedisit të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, privatë dhe publikë përmes zbatimit të drejtë të ligjeve dhe Kushtetutës", është theksuar në komunikatën e Odës Amerikane.

AKP-ja SHPALLI SHITJEN E ASETEVE TË NDËRMARRJEVE PËRMES LIKUIDIMIT NR. 45

PRISHTINË, 1 MARS (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka shpallur të premten shitjen e aseteve përmes likuidimit nr. 45. Lista e tenderëve për privatizim me shitje të aseteve nr. 45 përmban 98 asete, njësi dhe të gjitha këto do të privatizohen përmes metodës së shitjes përmes likuidimit. "Kjo valë e shitjeve me të gjitha asetet e tenderuara është aprovuar në Bordin e Drejtorëve, kurse AKP-ja i ka njoftuar paraprakisht të gjitha komunat përkatëse se këto asete të ndërmarrjeve shoqërore do të privatizohen dhe ka shpallur njoftimin për tender në faqen e saj të internetit dhe në mediat e shkruara dhe ato elektronike", thuhet në njoftimin e AKP-së.

Ofertat e mbyllura për njësitë, asetet në vijim duhet të dorëzohen në "Sallën e konferencave - 'Hoteli Grand'", në Prishtinë, më 3 prill 2019, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, të shoqëruara edhe nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, ashtu siç është parashikuar për secilin artikull. Kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë (3 prill) duke filluar nga ora 12:30.



Prokuroria Themelore në Ferizaj për një muaj ka ngritur 199 aktakuza

Ferizaj, 1 mars (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj gjatë muajit shkurt 2019 ka ngritur gjithsejtë 199 aktakuza për raste të ndryshme penale. Në Departamentin e Krimeve të Rënda janë ngritur gjithsejtë katërmbëdhjetë aktakuza ndaj njëzetë e një personave. Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie gjatë muajit shkurt ka ngritur gjithsejtë 176 aktakuza, ndërsa Departamenti për të Mitur ka ngritur nëntë aktakuza. Prokuroria Themelore në Ferizaj mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, ngritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.

QKMF-ja në Prishtinë ofron shërbime falas të mamografisë

Prishtinë, 1 mars (ER) - Për ta shënuar 8 marsin - Ditën Ndërkombëtare të Gruas, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prishtinë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe me Klinikën e Radiologjisë në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), do ta fillojnë fushatën sensibilizuese "Zbulimi i hershëm, mbijetesë". "Nga dita e premte, 8 mars, deri në fund të muajit mars, çdo ditë, prej orës 08:00 - 14:00, në hapësirat e QKMF-së do të ofrohen shërbime falas të mamografisë së gjirit për gratë dhe vajzat mbi moshën 40 vjet. Sjellim në vëmendje se 1 nga 8 gra diagnostikohet gjatë jetës me kancer të gjirit. Mbi moshën 50 vjeç rastet janë më të shpeshta. Mbrojtja më e mirë është zbulimi i hershëm", ka njoftuar Komuna e Prishtinës. Sipas këtij njoftimi, Komuna e Prishtinës ka ftuar gratë dhe vajzat që t'i bashkohen kësaj fushate. "Mamografia është një metodë e përshtatshme për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Në një mamografi bëhen të dukshme edhe tumoret më të vegjël shumë më parë se të jenë të ndjeshëm me të prekur ose të njihen nga simptomat e tjera. Ftojmë gratë dhe vajzat që të na bashkohen në këtë fushatë dhe të informohen sa më mirë për këtë sëmundje dhe rëndësinë e zbulimit të hershëm të saj", është theksuar në këtë njoftim të Komunës së Prishtinës.

Jashari, zyrtarëve të OSBE-së: Jam i kënaqur me raportet e mira ndërmjet komuniteteve

Skenderaj, 1 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim drejtorin e Zyrës Rajonale të OSBE-së, Ilija Bondaleski, dhe zyrtarin e lartë për çështje të komuniteteve, Jordan Colon, me të cilët ka diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve. Jashari ka thënë se në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën e OSBE-së në Mitrovicë do të zhvillojnë disa programe dhe aktivitete me qëllim të avancimit të dialogut ndërmjet komuniteteve. "Jam i kënaqur sidomos për raportet e mira ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve që jetojnë në harmoni të plotë në fshatrat Bajë dhe Syriganë, ku para disa ditësh kam vizituar këto fshatra dhe i kam njoftuar banorët për projektet që do të realizohen gjatë këtij viti në këto lokalitete. U ndava i kënaqur edhe me vlerësimin e OSBE-së, që Skenderaj është ndër komunat e para në nivel të Kosovës me ofrimin e shërbimeve efikase ndaj qytetarëve", ka thënë Jashari.

Kuvendi Komunal voton aktin e themelimit të 'Muzeve të Prizrenit'

Prizren, 1 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, e ka quajtur lajm të mirë votimin e aktit për themelimin e "Muzeve të Prizrenit" nga ana e asamblistëve të Kuvendit Komunal të kësaj komune. Haskuka ka thënë se Prizreni ka plot rrëfime për të treguar nëpërmjet muzeve. "Prizreni njihet si 'qytet muze i hapur'. Duke kaluar nga rrugët e saj përplot monumente, vizitorët mund të mësojnë për ndikimet e ndryshme kulturore përgjatë historisë. Fatkeqësisht, nga katër muze të proklamuar në qytet, vetëm ai i Lidhjes është duke funksionuar si muze. Të tjerat shumicën e kohës janë të mbyllura për vizitorë apo nuk janë të strukturuar për t'i plotësuar kriteret elementare për të funksionuar si muze. Lajm i mirë është se asambleja komunale ka votuar unanimisht aktin e themelimit të 'Muzeve të Prizrenit', organi i cili do t'i strukturojë me përmbajtje muzetë ekzistuese që janë nën ingerencat e komunës sonë si dhe do të themelojë disa muze të rinj. Prizreni ka plot rrëfime për të treguar, ndërsa për qytetarët dhe vizitorët muzetë janë adresa më e saktë për gjetjen e tyre", ka thënë Haskuka, duke shtuar se themelimi i muzeve do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve duke rritur numrin e vizitorëve në Prizren.

LIKOSHANI DHE QIREZI E ZGJUAN NGA GJUMI PRISHTINËN

Sylejman KRASNIQI

Stina e pranverës për historinë shqiptare ka qenë, në shumicën e rasteve, ndjellakeqe. Shumë ngjarje të liga kanë ndodhur në muajt e parë të vitit. Këtë e kam vërejtur edhe vetë nga ngjarjet që i kemi përjetuar dhe nga mësimi i historisë sonë që nga Skënderbeu e këndej. Vdekja e Gjergj Kastriotit ndodhi në fillim të vitit. Në këtë stinë ndodhën edhe: Okupimi i Shqipërisë nga Italia fashiste, tërmeti me pasoja të ndjeshme në Shkodër dhe Ulqin, vrasja nga dora gjakatare e Jusuf Gërvallës, njërit nga ideologët e luftës për çlirim nga Serbia dhe Jugosllavia, suprimimi i autonomisë së Kosovës nën shtypjen nga tanket serbe, masakra e ushtrisë serbe në Likoshan dhe Qirez të Drenicës, lufta dhe rënia heroike e komandantit Adem Jashari me familje nga Prekazi, masakra e ushtrisë serbe në fshatin Reçak të Shtimes, shpërthimi i hidhur në Gërdec afër Vorës, dhe plot ngjarje të tjera të ngjashme, por të hidhura të kujtesës sonë historike.

Kësaj here po ndalemi pak për ta përkujtuar masakrën e Likoshanit dhe të Qirezit dhe ngjarjet që rrodhën pas kësaj masakre.

Në muajin nëntor të vitit 1997 u vra mësuesi Fadil Geci në fshatin Llaush të Skenderajt. Pati shumë njerëz në varrimin e mësuesit. Për herë të parë Ushtria Çlirimtare e Kosovës doli publikisht dhe e mbajti një fjalë rasti tek varri i mësuesit Fadil. Nga ajo ditë popullit të Kosovës iu ngjall shpresa se tani e tutje nuk jemi të vetmuar. Rinia jonë trimëreshë ka marrë pushkën në dorë dhe po i del për zot kësaj toke. Edhe përpara kishte bërë aksione dhe veprime luftarake, por nga masat e gjëra, edhe pse adhuroheshin këto aksione, shiheshin si me rezervë, jo pse dyshonin në këto aksione, por sepse dyshonin mos janë vetëm grupe të shpërndara dhe të paharmonizuara mes vete. Për këto dyshime kishin edhe një arsye pak më të fortë sepse edhe forca politike më e madhe shqiptare në Kosovë, pra Lidhja Demokratike e Kosovës, nisi të propagandojë kundër qenies së UÇK-së duke e përbuzur atë dhe duke e quajtur herë dorë e zgjatur e UDB-së, herë nxitëse nga Serbia për të bërë një masakër të përmasave të mëdha mbi popullatën me të vetmin qëllim që ajo (pra UÇK-ja) të jetë e irrituar nga masat e gjëra, të frikësohej popullata dhe të shuhej çdo pore e rezistencës shqiptare ndaj Serbisë. Kështu ndodhi edhe më 28 shkurt të vitit 1998 kur Robert Gerbaldi, diplomati amerikan, shkoi tek Ibrahim Rugova dhe i kërkoi atij që UÇK-ja të trajtohej si organizatë terroriste. Dhe pikërisht ashtu ndodhi. Në lajmet e mbrëmjes po të asaj nate, pra më 28 shkurt të vitit 1998, në të gjitha televizionet u tha se Gelbardi dhe Rugova u pajtuan që UÇK-ja është terroriste. Bile agjencitë e huaja thoshin se këtë e tha politikani i moderuar shqiptar Ibrahim Rugova. Na kujtohet të gjithëve se po në të njëjtën ditë Gelbardi kishte qenë edhe te përfaqësuesi politik i UÇK-së, Adem Demaçi. Por, bacën Adem nuk arriti ta bindë që edhe ky ta quante UÇK-në terroriste. Flitej se në atë takim baca Adem e kishte krahasuar UÇK-në me Gjergj Uashingtonin për të cilën gjë Gerbaldi kishte reaguar shumë ashpër. Nuk e dimë a është rastësi, por në të njëjtën ditë, pra 28 shkurt të vitit 1998, u bë masakra e Likoshanit, në të cilën e pësoi familja Ahmeti dhe një mysafir e që mbetën të vrarë mbi dhjetë veta, dhe masakra e Qirezit ku u vranë disa anëtarë të familjes Deliu dhe familjes Gjeli. Me gjasë ky ka qenë edhe rezultat i të gjitha deklarimeve të asaj paraditeje.

Pas gjithë këtyre deklarimeve të mbara dhe të mbrapshta për situatën e krijuar në Kosovë dhe për mundësinë reale që gjendja të përkeqësohej, të gjitha partitë politike shqiptare dhe shoqatat e tjera qytetare vendosën që të nesërmen, pra më 01.03.1998, të mblidheshin në Prishtinë dhe të merreshin vesh për veprimet politike sepse parashihej se një rrebesh i paparë do të vërsulej mbi Kosovë. Kështu më 1 mars u mblodh këshilli koordinues i partive politike të Prishtinës në Medresenë e qytetit. Në këtë takim morën pjesë të gjitha partitë politike, Sindikata e Pavarur, Shoqata e të Burgosurve Politikë, Shoqata e Gruas etj.

Në kohën kur referuesi i parë del te foltorja për ta marrë fjalën, një qytetar hyn me vrap, si i pa frymë, në hollin ku mbahej takimi dhe, me një zë gati trishtues, thotë: "Nuk është më koha e fjalimeve sepse në Drenicë po masakrohet popullata". Aty u dëgjua nga të pranishmit për herë të parë për masakrën e Likoshanit e të Qirezit. Dhe, vërtet, më fjalimet nuk kishin kuptim. Tubimi mbaroi pa u fillua fare. Nga një përfaqësues i partive dhe i shoqatave të ndryshme u mblodhën në një sallë tjetër dhe u morën vesh për veprimet konkrete në pajtim me situatën e krijuar.

U vendos pa as më të voglën hamendje që të nesërmen, më 2 mars, të organizohej një protestë popullore në Prishtinë e në shenjë revolte për masakrën e Likoshanit e të Qirezit dhe për hatanë që pritej të ndodhte në tërë Kosovën. U zgjodh një këshill organizativ i protestave, me pjesëmarrës nga secila parti apo shoqatë, e cila kishte për t'i drejtuar ato. Në krye të këshillit shtatëanëtarësh u zgjodh Isa Kastrati (tashmë i ndjeri, dëshmor i kombit dhe njeriu i cili jetoi, veproi dhe ra vertikalisht për lirinë e Kosovës) sepse ai ishte edhe kryetari i këshillit koordinues i partive politike të Prishtinës. Në mbledhje u hodh propozimi që të merret edhe pëlqimi nga kryetari i Kosovës, Ibrahim Rugova, për protestën e dy marsit. Pati propozime dhe mendime të ndryshme rreth këtij pëlqimi.

Një nga anëtarët e këshillit tha se nëse e pyesim kryetarin e Kosovës për protesta ai nuk do të na lejojë sikurse që nuk i lejoi as protestat e studentëve të 1 tetorit të vitit 1997 për lirimin e objekteve shkollore. Bile ai (kryetari) atëherë nuk i pranoi për bisedë studentët e as rektorin e universitetit të Kosovës, tani të ndjerin, Ejup Statovci. Pas disa propozimeve u miratua vendimi që të shkojë te kryetari një delegacion prej tre anëtarësh dhe ta njoftojë atë për protestën që do të mbahet nesër. Po atë ditë këshilli vendosi që protesta të fillojë nga zyra e degës së tretë të LDK-së në Velani dhe këshilli protestues, në çdo rrethanë, të jetë në rreshtin e parë dhe t'iu prijë protestave. Të njëjtën ditë u morën parullat dhe pankartat nga studentët protestues të 1 tetorit të vitit të kaluar, të cilët na pritën me përkushtim dhe na dhanë udhëzime të domosdoshme për mbarëvajtjen e protestës.

Në këshillin e protestave kishte anëtarë të të gjitha moshave dhe të gjitha profesioneve. Kishte njerëz edhe me përvojë nëpër protesta e demonstrata që nga 27 nëntori i vitit 1968 e deri në vitet e nëntëdhjeta kur vrulli i protestave u shua pas daljes në skenë të LDK-së. Protestat e fundit ishin mbajtur në shtator të vitit 1990 dhe të organizuara nga Bashkimi i Sindikatave të pavarura të Kosovës. Pas një pushimi ose plogështie afër dhjetëvjeçare protestat e para u mbajtën nga rinia studentore më 1 tetor të vitit 1997 dhe tani këto të 2 marsit të vitit 1998. Ishte bindja se protestave të rinisë studentore nuk do t'iu bashkëngjiteshin qytetarët sepse për gati dhjetë vjet u mboll një psikozë e frikës dhe inferioritetit ndaj pushtuesit. Por vrulli i ndrydhur për kaq vite shpërtheu në përkrahje të studentëve më 1 tetor të 1997-s dhe më pas edhe më 2 mars 1998.

Partitë politike dhe shoqatat të cilat e përkrahnin luftën e UÇK-së kishin për qëllim që problemin ta bartnin nga periferia (pra nga luftimet nëpër fshatra) në qendër, pra nëpër qytete e sidomos në Prishtinë, kurse LDK-së kjo situatë i leverdiste. Pra, LDK-së i pëlqente që në fshatra dhe periferi të luftohej nga pak, por qytetet mos të përfshiheshin në luftime në mënyrë që opinioni i jashtëm ta krijojë përshtypjen se në Kosovë ka qetësi e në disa vende të izoluara nga pak konflikte sporadike.

Bile kryetari Rugova, bashkë me partitë e tjera satelite të LDK-së, i shpallën zgjedhjet e përgjithshme të cilat do të mbaheshin më 22 mars të vitit 1998, edhe pse në Kosovë luftohej dhe vdisej për liri. Ato zgjedhje madje quheshin të lira dhe demokratike. Mbaj mend rastin kur një polic serb në Kodrën e Trimave e ndali një të ri, ditën e zgjedhjeve dhe, ndër të tjera, e pyeti se a kishte votuar ende dhe kur i riu i tha se nuk do të votonte fare, polici e rrahu të riun, duke i thënë se ti qenke me Partinë Parlamentare të Adem Demaçit, prandaj nuk voton.

Pasi i patëm bërë të gjitha përgatitjet, të nesërmen, më dy mars, u mblodhëm të gjithë protestuesit në Velani, para selisë së Degës së III-të të LDK-së dhe filluam marrshin e protestës drejt qendrës së qytetit.

Rrugëtimin e bëmë nga rruga e Matit tek ish-ndërtesa e "Sllovenia Sportit", në rrugën "Agim Ramadani", në drejtim të Kuvendit të Kosovës, pas ndërtesës së komunës dhe dolëm në rrugën për tek ish-"Kino Rinia". Në rrugëtim e sipër na u bashkëngjitën një masë shumë e madhe qytetarësh. Aty tek sheshi para "Kino Rinisë" e mbajtëm një fjalim rasti të cilin e lexoi kryetari i këshillit të protestës, Isa Kastrati. Shumë qytetarë kishin dalë për t'iu bashkëngjitur protestës andej nga Ulpiana dhe Kodra e Diellit, por kishin hasur në kordon të policisë të armatosur deri në dhëmbë.

Para Fakultetit Filozofik turmën e protestueseve e kishte ndalur policia. Bile qendra e reagimit të policisë kësaj radhe kishte qenë para sheshit të fakultetit sepse aty i kishin parë disa profesorë dhe, duke menduar se ata janë krerët e protestueseve, kishin filluar përleshjet mes policisë dhe protestuesve, ku ka pasur shumë të rrahur, të përgjakur dhe të plagosur.

Në rrugën që shpie nga Salla e Sporteve "1 Tetori" e deri tek Instituti Albanologjik disa civilë serbë kishin ndezur makinat dhe turreshin t'i shkelin protestuesit.

Njëri serb e ndez një buldozer dhe e lëshon atë në teposhtëzen kah Mensa e Studentëve vetëm për ta trembur dhe plagos masën e protestuesve. Atë ditë u bë rrëmujë e madhe në qytet. U hodh shumë gaz lotsjellës dhe ujë nga cisternat. Pati shumë të rrahur dhe të plagosur. Protesta u përcoll nga të gjitha agjencitë e huaja dhe mori një jehonë në opinionin e jashtëm. Me këtë protestë u dha porosia e saktë se Kosova po vlon në të gjithë hapësirën e saj.

Në të njëjtën ditë, në mbrëmje, u takova me një vëlla të shokut tim. Fjala e parë, dhe para përshëndetjeve të zakonshme, që më tha ishte: "More shoq, kush do të përgjigjet për gjithë këto masakra mbi popullatën dhe për këto demonstrata të pakohë që po i nxitni ju…". Në fillim më zuri ngushtë sepse nuk e pritja këtë reagim prej tij, mirëpo shpejt e mora veten dhe iu përgjigja: "E po, sipas teje, mbi kë do të bie përgjegjësia nëse ne mbetemi gjithmonë në robëri dhe do ta kemi Serbinë mbi kokë tërë jetën?!" "Kjo që thua kurrë nuk më ka shkuar ndërmend", më tha bashkëbiseduesi dhe u ndamë. Shpejt u këndella dhe e kuptova për kënd e kishte fjalën ai shoku me këto akuza të rënda. Fjalën e kishte tek Adem Demaçi dhe UÇK-ja që po ua prishnin "qetësinë" para zgjedhjeve të 22 marsit. Sipas tij, pas zgjedhjeve do të bëheshim me institucione "demokratike" me të cilat do të mund të luftohej Serbia me mjete institucionale dhe pa dhunë. Bashkëbiseduesi e përcillte mendësinë pacifiste të LDK-së së cilës tanimë i kishte kaluar koha.

Kim Jong-Un nuk ndryshon qëndrim pas samitit me Trumpin

Phenian, 1 mars - Koreja e Veriut thotë se nuk do të ndryshojë qëndrim edhe nëse Shtetet e Bashkuara kërkojnë vazhdimin e bisedimeve.
Pas samitit ndërmjet presidentit të ShBA-së, Donald Trump dhe udhëheqësit të Koresë Veriore, Kim Jong-Un, Ri Yong Ho, zyrtarë të lartë të Koresë Veriore, kanë thënë se ShBA-ja ka refuzuar t'i heqë gjitha sanksionet ndaj Koresë së Veriut.
Megjithatë, ministri i Jashtëm i Koresë së Veriut, Ri Yong Ho, tha se delegacioni i tyre ka kërkuar që vetëm një pjesë e sanksioneve të hiqen dhe jo të gjitha. Ai tha se vendi i tij ka bërë një propozim "realist" i cili përfshinte neutralizimin e qendrës nukleare në Yongbyon nën mbikëqyrjen e vëzhguesve të ShBA-së.
Duke folur në një konferencë për media në Hanoi, presidenti amerikan ka njoftuar se nuk ka plane për mbajtjen e një samiti të tretë me Kimin.
Në programin origjinal të Shtëpisë së Bardhë ishte planifikuar që të enjten të organizohet "Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes së përbashkët", si dhe një drekë pune në mes të dy liderëve, mirëpo pritshmëritë janë shuar, kur të dyja ngjarjet janë anuluar në mëngjesin e së enjtes.

Stoltenbergu: Shkelja e traktatit nga Rusia, sfidë e ngutshme e sigurisë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenbergu, i bëri të premten thirrje Rusisë të rikthehet te zbatimi i traktatit të Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi, që ka shërbyer prej dekadash si gur themeli për kontrollin e armëve

Sofje, 1 mars - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s paralajmëroi të premten se shkelja nga ana e Rusisë e një traktati të rëndësishëm të epokës së Luftës së Ftohtë është një nga sfidat më të ngutshme për aleancën që lidhet me sigurinë.
Jens Stoltenberg i bëri thirrje Rusisë të rikthehet te zbatimi i traktatit të Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi, që ka shërbyer prej dekadash si gur themeli për kontrollin e armëve.
Muajin e kaluar Shtetet e Bashkuara pezulluan zyrtarisht detyrimet bazuar te marrëveshja e vitit 1987, që ndalon të gjitha raketat tokësore dhe ato balistike të afta për të përshkuar një distancë nga 500 deri në 5 500 kilometra, duke krijuar terrenin që traktati të përfundojë brenda gjashtë muajve. Rusia, që mohon të ketë kryer ndonjë shkelje, ndoqi të njëjtin shembull. "NATO-ja nuk dëshiron një luftë të re të ftohtë. Ne nuk duam një garë të re armatimesh dhe i bëjmë thirrje Rusisë të nisë të veprojë në përputhje me traktatin", tha Stoltenbergu pas bisedimeve me kryeministrin bullgar Bojko Borisov në Sofje.
"Raketat e reja ruse përmbajnë kapacitete bërthamore. Ato mund të arrijnë qytetet evropiane dhe janë të vështira për t'u interceptuar", tha Stoltenbergu.
Ai shtoi se NATO-ja duhet të përgatitet për një botë pa këtë traktat dhe me më shumë raketa ruse. Raketat me rreze të mesme veprimi konsiderohen veçanërisht destabilizuese pasi ato kërkojnë një kohë më të shkurtër për t'i arritur objektivat e tyre në krahasim me raketat balistike ndërkontinentale. Kjo praktikisht u lë pak kohë vendimmarrësve, të bëjnë dallimin mes një konflikti bërthamor botëror dhe një paralajmërimi të rremë.
Presidenti rus Vladimir Putin i bëri një paralajmërim të ashpër ShBA-së kundër vendosjes së raketave të reja në Evropë, duke thënë në fjalimin e tij vjetor për vendin muajin e kaluar, se Moska do të hakmerret duke dislokuar armë të reja që kërkojnë pak kohë për ta arritur objektivin.

ShBA-ja në kërkim të djalit të Bin Ladenit

Uashington, 1 mars - Shtetet e Bashkuara kanë ofruar një shpërblim deri në një milion dollarë për personat që ofrojnë informacione për njërin nga djemtë e ish-liderit të al-Kaidas, Osama Bin Laden.
Hamza Bin Laden thuhet se po udhëheq grupin militant islamik, thonë zyrtarët amerikanë. Sipas autoriteteve, ai është i vendosur afër kufirit që ndanë Afganistanin dhe Pakistanin. "Ne besojmë se ai

ndoshta është në kufirin afgan-pakistanez dhe do të kalojë në Iran, por ai mund të jetë kudo në Azinë Jugqendrore", tha ndihmësi i sekretarit për siguri diplomatike, Michael Evanoff, transmeton BBC.
Vitet e fundit, Hamza Bin Laden ka transmetuar audioincizime dhe mesazhe me video, duke bërë thirrje për sulm ndaj SHBA-së dhe aleatëve perëndimorë për hakmarrje ndaj vrasjes së babait të tij.
Në një regjistrim të korrikut të vitit 2016, Hamza bin Laden kërcënoi me hakmarrje kundër ShBA-së për vrasjen e babait të tij. "Nëse mendoni se krimi juaj mëkatar që keni kryer në Abbottabad ka kaluar pa dënim, atëherë keni mendu-ar gabimisht", tha ai.
Hamza Bin Laden, rreth 30 vjeç, është cilësuar nga ShBA-ja si terrorist global dy vjet më parë. Departamenti Amerikan i Shtetit kishte thënë se ai është martuar me vajzën e Mohammed Atta, i cili ka organizuar sulmin e vitit 2001, duke rrëmbyer njërin nga aeroplanët komercialë për ta goditur ndërtesën në Nju Jork.
Letrat e Osama Bin Ladenit të gjetura në kompleksin ku kishte jetuar tregojnë se Hamza ka qenë djali i tij i përzgjedhur për të zëvendësuar atë si udhëheqës i Al Kaidës. Hamza Bin Laden besohet se ka kaluar disa vjet me nënën e tij në Iran, ndërsa disa raporte bëjnë me dije se ai ka jetuar në Pakistan, Afganistan dhe Siri.

E djathta evropiane shton thirrjet për sanksionimin e Orbanit

Bruksel, 1 mars - Thirrjet për ta sanksionuar kryeministrin hungarez Viktor Orban sa vijnë dhe shtohen brenda së djathtës evropiane. Hipotezat e përjashtimit nga partia e liderit populist hungarez po përforcohen, kur na ndajnë vetëm tre muaj nga rinovimi i Parlamentit Evropian. "Të gjitha opsionet janë mbi tryezë. Jemi aktualisht në proces diskutimesh brenda Partisë Popullore Evropiane, PPE", deklaroi Manfred Weber, lideri i kësaj force politike.
PPE-ja, ku bën pjesë edhe partia Fidesz, e kryesuar po nga Orban, rigrupon partitë politike të së djathtës dhe qendrës së djathtë në shkallë evropiane. "Me deklaratat dhe fushatën e tij Viktor Orban ka dëmtuar ndjeshëm PPE-në. Nisur nga kjo arsye unë pres nga ai që të kërkojë ndjesë dhe t'i ndalë këto veprime", sqaron Weber, anëtar i CSU-së, partia simotër e CDU-së e kancelares, Angela Merkel.
Kryeministri hungarez përshkallëzoi edhe më tej situatën 10 ditë më parë me nisjen e një fushate dashakeqe kundër presidentit të Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, duke e akuzuar Brukselin se po mbështet migracionin.

Bradley Cooper ka pasuri prej 100 milionë dollarësh

Bradley Cooper së shpejti do të marrë një pagesë të majme nga filmi "A Star Is Born". Aktori 44-vjeçar ka qenë skenarist, regjisor ,madje edhe aktor në versionin e ri të mjuzikllit, ku luante përkrah Lady Gagës. Ky film ka arritur të marrë tetë nominime për çmimin Oscar këtë vit, derisa ka triumfuar në kategorinë "Kënga më e mirë origjinale" për këngën "Shallow". Duket se "A Star Is Born" do t'i sjellë shumë të ardhura aktorit. Filmi "A Star Is Born" ka arritur të grumbullojë deri tash fitime bruto prej 425 milionë dollarë, në ndërkohë që buxheti për prodhimin e tij ka qenë 36 milionë dollarë.



Rita Ora në bashkëpunim me reperin e famshëm

Këngëtarja e famshme me prejardhje nga Kosova, Rita Ora, ka publikuar këngën më të re. Këtë e ka bërë me dije përmes llogarisë së saj në "Instagram". Një nga fansat e ka pyetur nëse do të ketë ndonjëherë ndonjë bashkëpunim në të ardhmen me reperin amerikan Eminem, së cilës ajo i është përgjigjur me pozitivitet. "Të lutem tregoj Eminemit se është shumë i mirëpritur", ka shkruar në koment bukuroshja 28-vjeçare.

Javier Bardemi dhe Penelope Cruzi shndërrojnë oscarët e vet në llamba

Javier Bardem ka treguar se ai dhe bashkëshortja e tij Penelope Cruz janë treguar kreativë me çmimet e tyre Oscars duke i shndërruar në llamba. Bardemi ka fituar çmimin Oscar për rolin dytësor në filmin "No Country for Old Men" të vitit 2007 derisa Cruz ka fituar Oscarin e saj për rolin, po ashtu dytësor për filmin "Vicky Cristina Barcelona". Aktori ka treguar se ata kanë kthyer oscarët në llamba që qëndrojnë në tavolinat anash shtratit të tyre.

Reperi 2 Chainz publikon albumin e ri

Reperi 2 Chainz ka publikuar albumin më të ri. Ky album quhet "Rap or go to the league" dhe përmban katërmbëdhjetë këngë. Reperi 2 Chainz ka pohuar se ka punuar shumë për këtë album.

NË LABORATORËT SEKRET TË HOLANDËS, KU "GATUHET" GJITHË EKSTAZA NË BOTË

Të fshehur në mesin e kullotave dhe serrave, gjeneratat e kriminelëve prodhojnë sasi të mëdha të barnave sintetike. Dhe i kthejnë ato nga riviera e Adriatikut në Australi. Një luftë e pabarabartë për policinë. Parlamenti po debaton rregullimin e këtyre substancave

Kullotat, serrat, kanalet. Kuajt e zjarrtë, dele me fytyrë të zezë, kamionë që vijnë dhe shkojnë. Nëse raportet e policisë nuk e kanë shkruar atë, do të ishte e vështirë të imagjinohej në këtë zemër të gjelbër, të lagësht dhe të pastër të Europës laboratori botëror i ekstazisë dhe i shpejtësisë, ende "ilaçe të rënda", pra të paligjshme. Duke qarkulluar në një diskotekë në Rivierën e Adriatikut, në një party në Ibiza, në një apartament nën çati në Nju Jork, është e mundur të thuhet se pilulat u përmblodhën këtu: midis Brabantit dhe Limburgit, në Holandën e Jugut, në "kufirin e trefishtë" me Belgjikën dhe Gjermaninë.

Një erë e keqe, thotë Agjenti Willem-Jan Uijtdehage, i ndryshëm nga tymi i plehrave apo era e fermave industriale: është spiuni i parë.

Aktiviteti frenetik i natës, alarmi i dytë, kalimi i vazhdueshëm i automjeteve; dhe pastaj dritare të errëta, madje edhe me dërrasa druri, ku tradita është që të mbahen transparente. Është hapur një fushatë që mund të çojë në këtë depo anonime pas një pompë gazi në rrugën për në fshatin Lage Zwaluwe, kënetat, anijet e peshkimit, shtëpitë me perde të qëndisura.

Ose për këtë tregtar makinash në fshatin Rijen, i cili ende paraqet modele të vjetra, karnaval gjithandej me një kuzhinier grotesk dhe një tenxhere në zjarr, një rimorkio për patate të skuqura. Laboratori, një nga më të mëdhatë që u gjet ndonjëherë, ishte në derdhjen e bardhë që tani ekspozon shenjën: "Mbyllur me urdhër të kryetarit të komunës për shkelje të ligjit holandez mbi drogat, ndalohet të afroheni".

Ishte nën tokë dhe ishte një murtajë, thotë polici, duke treguar një video që e kishin xhiruar kolegët e tij: "U deshën disa ditë për ta rimarrë atë".

Fuçitë e mëdha të kimikateve, tubave, ampave, miasms. A është e mundur që fqinjët kurrë të mos kenë vënë re ndonjë gjë? Fqinji sapo kishte besuar një fëmijë në atë që duket si një dado, buzëqesh me një buzëkuq të zbehur dhe shtrëngon kokën: "Nuk kisha dyshime, shiste vetëm makina". Shtëpi të vogla me tarraca, bar i djegur nga të ftohtit, disa gnomë të kopshtit. Kimistët nëntokësorë të Brabant janë të gjithë holandezë ndër breza, të rrënjosur dhe të mbrojtur nga territori. Mishërimi i fundit i legjendave të lashta.

Në anën e pasme të dhive fluturuese

Ata u quajtën "bokkenrijders", tashmë në shekullin e tetëmbëdhjetë u ndaluan me një atmosferë djallëzore që bastisnin fshatrat, në folklorin lokal në shpinë të dhive fluturuese, në një tokë të kufijve labile dhe në shumë rrugë shpëtimi. Kur Traktati i Mastrihtit i vitit 1843

krijoi kufirin midis Belgjikës dhe Holandës, ata u bënë shifra më konkrete, të dedikuara për një aktivitet të veçantë: kontrabandë. Gjalpë, kripë, sende ushqimore, për fillestarët. Provincat e varfra dhe të margjinalizuara të Holandës; Katolikët në një vend protestant; strehimi social në vitet midis luftërave, pastaj pas Luftës së Dytë Botërore, një prerje të fuqishme në subvencione: "Në fillim ishin njerëz që i kishin mbijetuar aq sa mundeshin", shpjegon Hessel de Ree, kronikanët më të respektuar të zi në rajon. Djemtë e varfër, kryesisht të kampit në karvanët, por me trafikimin e jenever, një lloj xhin indigjen, ata bëjnë një kërcim në cilësi: ata fillojnë të distilojnë.

"Cook" MDMA ose amfetamina nuk është aq e ndryshme, por është shumë më e dobishme. Jemi rreth viteve të tetëdhjeta, kur aftësitë janë të rafinuara dhe holandezët bëhen më të mirët nga të gjithë. Ata i kthejnë tabletat nëpër botë me ndihmën e mafias izraelite, grumbullojnë pasuri dhe mbulojnë karvanët e kartëmonedhave; ata u japin personazheve të shtypit karizmatik si John Heijnen, bujar bon vivant i York-bende, protagonistë të viteve nëntëdhjetë.

Pak roje, shumë hajdutë

Drejtësia ka zhdukur siç mundet, në vend që të njëjtët agjentë, në një sondazh të bashkimit vitin e kaluar, ta përcaktojnë atë si Narco-Shtetin. Burra të varfër për policinë, ligje që ende nuk kanë marrë shoqatën kriminale të tipit mafioz, dënime të lehta dhe një politikë tradicionale të tolerancës, gedoogbeleid, i cili në fushën ndërkombëtare të tregtisë përfundon duke lënë hapësirë për të gjitha aktivitetet, ligjore apo jo. Porti më i madh europian, Roterdam, në pak kilometra, i dyti, Antëerp, në distancë të barabartë mbi kufirin belg. Rrugët, kanalet, aeroporti Schiphol, infrastruktura më e mirë e mundshme; lehtësimin e taksave dhe lehtësinë e riinvestimit, për çdo lloj biznesi. Përfshirë italianët.

"Këtu ka shumë piceri që nuk bëjnë pica", thotë De Ree. Kjo është konfirmuar nga operacioni i përbashkët "Pollino", i cili në dhjetorin e kaluar çoi në 84 arrestime midis Kalabrisë dhe Europës Veriore, dyqaneve të mbyllura, 4 mijë kile kokainë dhe 140 në tableta të kapura ekstazi. Biznesi kryesor, më i madh nga Amerika e Jugut në Holandë, ende sillet rreth kokosit, por "Pollino" tregon se rruga e vjetër artizanale e ndjekur nga drogat sintetike është e ndërthurur me rrjedhat më të mëdha, shpesh në shkëmbimin e substancave si një formë pagese, në rrjetet e shpërndarjes, në kontrollin e kontejnerëve: prekursorët e nevojshëm për laboratorët arrijnë në sasi të mëdha, nga deti, kryesisht nga Kina.

Kriminelët e vjetër holandezë filluan të bashkohen pastaj me turqit mafiozë, bandat marokene, grupet shqiptare apo ruse, si dhe eksponentët e 'ndrangheta dhe 'camorra'. Sepse produkti është i mesëm, por ka një diferencë shumë të lartë fitimi: 16 cent për të mbledhur një pilulë që bëhet 20 dollarë në Shtetet e Bashkuara, 30 në Australi. Është e qartë se vlen të eksportohet. Tregu i brendshëm është shumë më i lirë: një tabletë mund të kushtojë deri në vetëm 2 euro. Megjithatë, vazhdon të jetë i pajisur mirë dhe lehtësisht i arritshëm.

Një pilule mund të kushtojë vetëm 2 euro

Në Amsterdam mënyra më e sigurt është ta thërrasim furnizuesin sikur të ishte një taksi, të presim që ai të vijë me "katalogun" dhe të zgjedhë. Artisti Jozef v. d. H. konsumon ekstazi rregullisht nga festivali muzikor elektronik të viteve tetëdhjetë: "Unë nuk kam asnjë arsye për të mos", buzëqesh ai. Por, në të vërtetë ajo ka vëmendjen e vet: një shtytës i besueshëm dhe një çantë në shtëpi për të kontrolluar cilësinë e tabletave në rast dyshimi. "Ka gjithashtu mundësinë e marrjes së tyre në laboratorë të specializuar për t'i analizuar ato".

Sepse pika është se në heshtje nëntokësore askush nuk mund të dijë me siguri se cilat substanca janë përzier, dhe nga njerëzit e djegur apo edhe të vrarë të gjithë në Holandë mund të tregojnë të paktën një anekdotë. Është e pamundur, për shembull, që të ketë garanci për shitjen në Telegram nga ajo Jordani: 5 tableta që imitojnë logon e modës Philipp Plein në 20 euro, 10 në 35, deri në 50 për 100 euro. Një ofertë në mesin e shumë tabletave të çdo ngjyre dhe forme, në mesin e grumbullimeve të fundit është portokalli me trungun e Trump. "Është sistemi i ri i shitjeve të drogës – shpjegon Koen Voskuil, autor i Maffia Paradijs – pas një operacioni të madh policor në rrjetin e errët, trafiku ka lëvizur në Telegram, i cili megjithatë është i koduar". Nëpërmjet kontakteve të tij, Voskuil arriti të futet në një treg të paligjshëm me një emër të rremë, shmangu mallrat në ekran në telefonin e tij celular: "Përveç drogës, ka armë, uniforma të vjedhura të policisë, marka të falsifikuara dhe viagra".

Rregullat e larta

Një rend aq i pafund që jep idenë se sa e vështirë është të ndërhysh. Deri në pikën që edhe në ekstazë në Holandë është hapur një debat: a është koha për të ndryshuar strategjinë? Udhëheqësi i propozimit është një deputet i Gjelbër, Kathaljne Buitenëeg. Dhe ekziston një qëndrueshmëri: çështja është gjithashtu ekologjike për derdhjen e mbetjeve kimike të përpunimit në tokë dhe në ujëra nëntokësore. E takojmë atë në Parlamentin e Hagës. "Politikat për të luftuar krimin e zbatuar deri më tani kanë dështuar, – vëren ai. – Konsumi i ekstazisë është rritur dhe kështu ka prodhim, qarkullim, ndotje". Pra, linja e tij: "Le të shqyrtojmë politikat mbi drogat dhe të konsiderojmë rregullimin e ekstazës".

Kryeministri Mark Rutte ka thënë se është e keqe për shëndetin, ministri i Drejtësisë, Ferdinand Grapperhaus (CDU) ju lejon të dini me një mesazh në Courier se propozimi "nuk është në rendin e ditës". Buitenëeg thotë: "Një hipokrizi kur substanca të rrezikshme si fentanyl janë në treg. Dhe sigurisht është në axhendë, pasi ne po diskutojmë …"

Shumë debate publike në Amsterdam, vetëm pak ditë më parë lëvizja rinore e D66 (liberale në qeveri) ka organizuar edhe një veprim demonstrativ me pilula. Dhe gjithashtu në komunat Brabant tema është dëgjuar. Kryebashkiaku i Bredës,

laboranti Paul Depla, na pranon në studion e tij të mbuluar me mbulesa rekorde. Nuk e marrin atë lehtë, të saktë, ai beson në luftën e ashpër ndaj kriminelëve dhe ishte kërcënuar gjithashtu. "Por nëse unë jam afër bashkëqytetarëve të mi: shkoni në disko, por mos përdorni ekstazi, ata janë si Papa kur thotë se nuk keni marrëdhënie seksuale para martesës. Askush nuk më dëgjon". Ai gjithashtu ka idenë e rregullimit: "Në fund, nuk dëmtojnë më shumë se alkooli dhe cigaret".

Ana e errët

Karl Kasper, një edukator në periferi të Amsterdamit, është më pak i bindur: "Unë kam parë shumë djem të dëmtuar nga acidet, të bëhen psikotikë ose me probleme të tjera mendore". Nga të gjitha substancat sintetike në qarkullim, thotë ai, më e keqja dhe më e përhapur në periferi është GHB, e quajtur edhe "droga e përdhunimit", sepse ajo çaktivizon dhe i frenon "viktimat". Është bërë edhe në shtëpi, më shpesh në laboratorët klandestinë, me materiale të papërshtatshme, detergjentë dhe tretës, shpërndahet në shishe të lira, bën zombies dhe prodhon varësi. "Është shumë e rrezikshme".

Kasper sheh nga rruga një peizazh gjithnjë e më të zymtë, njolla edhe me gjak. Ai gjithashtu i tha reporterit De Ree: nuk janë të gjitha tulips dhe dyqane kafeje, kjo trafikimi gjigant i drogës që në Holandë sjell dhunë. Vendi është bërë i vetëdijshëm vetëm kohët e fundit, me ngjarjet mbledhur nga Wouter Laumans në mocro Maffia, tani edhe dramë popullore televizive. Duke filluar nga viti 2012, lojëra të mëdha të koka, SUV të fuqishëm, festa, të shtëna, ndjekje, fëmijë të emigrantëve nga Maroku ose Antilles.

"Deri në atë moment, në nëntokën tonë, ne kishim për të regjistruar të dhëna kundër kriminelëve 40-vjeçarë, – thotë Laumans në një bar në jug të Amsterdamit – papritmas hetuesit e kuptuan se skenari ka ndryshuar" dhe është shumë më i ngjashëm me Gomorra e asaj që ata imagjinonin. "Nuk janë vetëm kontrabandistët e vjetër holandezë, në të cilët policia është përqendruar gjithmonë: ekonomia e zezë është e re dhe shfaroset". Në një seria televiziv do të ishte material i bollshëm për shumë episode të tjera.

(Gazeta Shqip)

Autor: GAZMEND MORINA

QË BESON VERBËRISHT NË DOGMËN FETARE
ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE
PIJE FRESKUESE E ATHËT (sh.shq.)
SOLISTJA ... BYTYQI
SPIUNIA E FAMSHME .... HARI
EPOKA E RE
NDESH
ANTON PASHKU
KOMANDANT I NJË ANIJEJE
SFOND SHKRONJASH
FAREFISI (bised.)

LUTEM (fet.)
HEROI ZEJNULLAHU

SHPIRTI (Lat.)
PANDJESI I PËRQESHUR

PËSHPËRIT FJALË MAGJIKE
PRAPA KRUJA, APOLONIA

PËRGJIGJE NË TELEFON
AGIM TEJECI / AZEM BEJTA
SHTET NË AMERIKË / FALJE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT

KËNGËTARJA .... TARNER
RROGA VJETORE E PAPËS / ELIZA DUSHKU
SHKENCA QË STUDION METODAT DHE MJETET E HETIMIT E TË ZBULIMIT TË KRIMEVE

AKTORJA E FAMSHME ITALIANE ROSSELLINI (shqip.)
"E" para dy "K" / HYJNI E DASHURISË (mit. romake)

MUZIKANTI AMERIKAN ... ROCK
RE E DENDUR TYMI / SHUMË E GJATË
BASHKËT. / UDHËHEQËSI I NJË PARTI POLITIKE

EPOKA E RE
KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO
JONI ME NGARKESË NEGATIVE
NËNREPART USHTARAK I PËRBËRË PREJ DISA TOGASH
ENË PËR TË NXJERRË UJË NGA BUNARI (shq.) / FUTBOLLIST PORTUGEZ
IGLI TARE
"A" në mes të dy "M" / PJESË E FORTË E BUKËS (sh.shq.)
KORNIZË / VËNIA E MINAVE
BRUS .. / TATUAZH (bised.)

QË SHPREHET ME PAK FJALË E NË MËNYRË TË PRERË
KAMION I VOGËL / QË KA TË BËJË ME FSHATINË, FSHATARESKE
FJALË E DHËNË PËR DIÇKA / KANAPE E GJERË DHE E GJATË

PËRTËRITËS
RIDERS (shk.) / MARK ANTONI
KËNGËTARJA ROZANA .... / ZANORE

PORT DETAR
SHTET NË EVROPË / MJET UDHËTIMI E TRANSPORTI (shq.)
NGJYRË E FYTYRËS / NOTË MUZIKORE

KING OF PRUSSIA
PËRSËRITËS (gram.) / PJESË E EPËRME E DHOMËS
ILUZIONISTI SHQIPTAR NADIR .... / RENS ISTVUD

MËRI, ZILI
REOMIR, TANTAL / SHKRIMTARI HAZIRI (shq.)
AKTORI EGJIPTIAN SHARIF (shq.) / LLOJ I LETËRSISË EPIKE
IRMA LIBOHOVA / ROBERT REDFORD

KULLË E XHAMISË
DIKTATUR RUS
RAVENA / DUKAT
ZANORE / BOSHT

JAM I DENJË TË NDEROHEM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM A NJË SHPËRBLIM
FUTBOLLISTI KROAT KLASNIÇ / PARIA E SHOQËRISË
EPOSI / VEPRIMTARI I SHQUAR PETRO .... LUARASI
MJET PUNE (shq.)
REKUIZITË SPORTIVE (shq.)
NËPËR ARA, ARAVE / PËREMËR VETOR

BASHKË, TOK (bised.)
"ASHTU QOFTË" / KALIBËR I TYTËS SË ARMËS
QË NXË NJË OKË (PËR ENËT) / BËRTHAMOR
KASTRIOT TUSHA / SPORT LUFTARAK

SHKRIMTARJA KADARE
I BËJ APEL / ZANORE
KNOWLEDGE SYSTEMS INSTITUTE / NJËSI PESHE PËR GURËT E ÇMUAR

RITUAL
SHKRIMTARI ALIGIERI / LËNDË MËSIMORE
PERIUDHË E GJATË DHE E RËNDËSISHME HISTORIKE / VENDËS, RRËNJËS
BASHKËT. / NDËRRIM I MALLIT

VENDLINDJA E ODISEUT
DY ZANORE / ISLANDA
KALI I STËRVITUR MA JEP
KËNGËTARJA BAJRAMI / ANNAPOLIS PERFORMANC E SAILING

KRYEQYTETI I ESTONISË
HUQ, VES / VARIOLË
BUJK / BASHKËT.
TEDI ALVES

OSAKA
NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE / ZANORE
SUPER MODELJA ADRIANA / BASHKËT.
ARMË E FTOHTË PREJ ÇELIKU (sh.shq.) / ONTARIO

RILINDËSI .... VRETO
PIKTORI PABLO
EMBLEMA

E jashtëzakonshme

Rosa me aftësi të kufizuara ecën me karrige me rrota

Një rosë e lindur me këmbë të gjymtuar tani mund të ecë falë një karrige me rrota. Rosa e quajtur Merlin u adoptua nga Goats of Anarchy Sanctuary në Nju Jersey në nëntor të vitit të kaluar, por nuk mund të lëvizte për shkak të një defekti në këmbë. Në këtë mënyrë Sanctuary kontaktoi me Walkin' Pets, që dizajnon karrige me rrota për kafshët



shtëpiake me aftësi të kufizuara. Zakonisht karrigia me rrota përdoret për macet dhe qentë, por u modifikua për t'ju përshtatur trupit të Merlinit.

FOTO E DITES

Jerusalemi përfshihet nga vërshimet e shkaktuara nga shiu i rrëmbyer. /AFP/

E rrallë

Mbahen "peng" nga macja, por shpëtohen nga zjarrfikësit

Dy gra janë mbajtur 'peng' nga macja, e cila papritur u bë agresive, por më pas ato janë shpëtuar nga zjarrfikësit. Kështu u ka ndodhur dy grave, nënë e bijë, të enjten në Gjenova të Italisë. Dy gratë u sulmuan nga kafsha e cila i gërvishti dhe kafshoi derisa i detyroi ato të mbyllen në një dhomë.

BARSOLETA E DITËS

Që kur jam divorcuar nuk po e bëj më gjumin rehat.
- Pse, aq shumë të mungon?
- Jo mor burrë, por ma mori gruaja krevatin.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 14:00

"SHEEP AND WOLVES" 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev



Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

"BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

""SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI Jeni shumë të ndjeshëm sot dhe emotiviteti juaj do të jetë ngjitës. Në ambientin shoqëror do t'ju bashkohen edhe miqtë në të njëjtën gjendje.

DEMI Veprimet shkojnë paralel me mendimet tuaja se si duhet finalizuar një projekt. Keni qenë gjithmonë mjaft praktikë dhe kjo ju ndihmon ngado.



BINJAKËT Sot jeni të fokusuar vetëm tek ndjenjat dhe tek dashuria. Për ata që janë çift partneri është kryefjala e ditës ndërsa për të tjerët po ëndërroni për dikë që e keni pranë.

GAFORRJA Intuita juaj ju ka ndihmuar të zgjidhni opsionin e duhur në një marrëveshje të momenteve të fundit.

LUANI Mendja juaj ka kohë që mendon për vende të largëta. Doni të zhvendoseni diku, por do të jetë një vendim definitiv.

VIRGJERESHA Do të dëgjoni shumë fjalë sot, por asnjëra prej tyre nuk do të rezultojë e vërtetë në fund të ditës, duke bërë që të dilni keq përpara një miku.

PESHORJA Keni një ngërç në raportin me partnerin që nuk po arrini dot ta tejkaloni as ju as pala tjetër. Do t'ju çojë drejt një ftohjeje akoma më të madhe.

AKREPI Yjet nuk janë në anën tuaj sot dhe do t'ju pengojnë në ato pjesë të ditës që i mendonit si më të mirat dhe më të realizuarat.

SHIGJETARI Keni mjaft punë për të mbyllur sot edhe ato gjëra që i keni lënë për një moment të dytë, por që nuk mund të presin më.

BRICJAPI Stabiliteti dhe mirëqenia e familjes tuaj janë ato që po ju shqetësojnë sot. Një problem i lindur se fundmi ju ka venë në mendime.

UJORI Nuk është një nga ato ditët më të mira kjo e sotmja, por do të dini t`i jepni ngjyra edhe pse paraqitet shumë gri.

PESHQIT Duket sikur kjo ditë e parë e muajit nuk është dhe aq e gëzueshme, por me kalimin e orëve çdo gjë do të rregullohet në favorin tuaj.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE						
	LAZIO - ROMA	GG3+	REAL MADRID - BARCELONA	X	SCHALKE - F. DUSSELDORF	1-1

Zhdrella dhe Boshnjaku: Luajmë për fitore

Sot Llapi dhe Prishtina kërkojnë fitore në mënyrë që të mbesin në hap me Feronikelin në garë për titullin e kampionit në Superligë. "Do të jetë ndeshje interesante dhe një derbi i fortë, pasi synimet e të dy klubeve janë të njëjta. Pavarësisht prej formës që ka Prishtina, mund të them se gjithmonë është një skuadër e rrezikshme, prandaj duhet të kemi kujdes dhe mos të lejojmë gabime. Pres angazhim maksimal dhe fitore që na mban në garë për titull", ka thënë Mentor Zhdrella

EPOKA E RE — Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 MARS - Mesfushori Mentor Zhdrella ka paralajmëruar se skuadra e Llapit është e përgatitur maksimalisht dhe synon fitore në derbin ndaj Prishtinës, i cili zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Zahir Pajziti". Ish-lojtari që bëri historinë në futbollin e Kosovës, duke u shpallur për disa vjet më i miri, ka thënë se Prishtina është një kundërshtare e fortë, por pikët mbesin në Podujevë. "Do të jetë ndeshje interesante dhe një derbi i fortë, pasi synimet e të dy klubeve janë të njëjta. Pavarësisht prej formës që ka Prishtina, mund të them se gjithmonë është një skuadër e rrezikshme, prandaj duhet të kemi kujdes dhe mos të lejojmë gabime. Pres angazhim maksimal dhe fitore që na mban në garë për titull", ka thënë Zhdrella për "Epokën e re".

Ashtu sikurse Llapi, edhe Prishtina ka synime të mëdha në ndeshjen kryesore të javës së 20 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Lorik Boshnjaku i Prishtinës ka thënë se të dyja skuadrat kanë nevojë për pikët e plota, por fitorja do t'i takojë skuadrës nga kryeqyteti. "Me Llapin duhet fokusim maksimalisht. Është skuadër e fortë dhe pretendente, por çdo rezultat tjetër përveç fitores e eliminon nga gara, sepse mbetet shumë larg. Në pozitë të njëjtë jemi edhe ne. Na duhet fitorja patjetër që të mbesim në garë me Feronikelin. Shkojmë që ta fitojmë ndeshjen. Shpresoj të na ecë ashtu siç e kemi planifikuar. Me fitore do të prisnim qetë kush është më i mirë në përballjen me Feronikelin", ka thënë Bosnhnjaku për faqen zyrtare të Prishtinës.

Skuadra e Llapit aktualisht pozicionohet në vendin e tretë në renditjen tabelore me 38 pikë, ku nga 19 ndeshje të zhvilluara ka arritur 12 fitore, dy barazime dhe pesë humbje. Ndërsa skuadra e Prishtinës është e dyta me 43 pikë, kurse ka regjistruar 13 fitore, 4 barazime dhe 2 humbje.

Fitojnë Drita dhe Ferizaj, Liria dhe Gjilani ndahen baras

Skuadra kampione në fuqi, Drita, ka shënuar fitore para tifozëve të vet në duel me Drenicën, me rezultat 2-0, në kuadër të javës së 20 në IPKO Superligë. Megjithatë, për të arritur deri te fitorja gjilanasit vuajtën shumë. Në fakt, të dyja golat u shënuan vetëm në minutat shtesë. Fillimisht shifrat i zhbllokoi Kyrian Nwabueze (90'+1'), kurse golin e dytë e realizoi Xhevdet Shabani nga penalltia (90'+5'). Tri pikë tejet të rëndësishme në garën për mbijetesë i ka arkëtuar Ferizaj që, para tifozëve të vet, ka shënuar fitore kundër Ballkanit me rezultat 1-0. Golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi Bashkim Shala në minutën e 85-të. Ndërkaq, ballafaqimi i zhvilluar në stadiumin "Përparim Thaçi" në Prizren, ndërmjet Lirisë dhe Gjilanit, është mbyllur pa fitues, 1-1. Të parët në epërsi kaluan prizrenasit me golin e Blendi Memajt në minutën e 30, por Gjilanin nga humbja e shpëtoi Keita Razak me golin e shënuar në minutën e 75-të.

IPKO SUPERLIGA

Ferizaj - Ballkani	1-0
Drita - Drenica	2-0
Liria - Gjilani	1-1

Të shtunën takohen:
KEK-u - Feronikeli
Llapi - Prishtina
Flamurtari - Trepça '89

LIGA E PARË

Të shtunën takohen:
Istogu - Vitia
Fushë Kosova - Ramiz Sadiku
2 Korriku - Arbëria

Të dielën takohen:
Besa - Trepça
Dukagjini - Onix
Vushtrria - Kika

SHKURT

Grezda: Dua të jem në fushë ndaj Turqisë

Eros Grezda është rikthyer nga lëndimi dhe po përgatitet për t'u rikthyer në fushën e lojës. Sulmuesi kuqezi me padurim po e pret ndeshjen ndaj Turqisë, kurse shpreson të jetë titullar dhe të përsëritet historia e ndeshjes miqësore e dy vjetëve më parë. "Kam shumë dëshirë të jem në fushë dhe ta përsërisim atë sukses të dy vjetëve më parë. Besoj se motivimi është te të gjithë lojtarët dhe me padurim e presin atë ndeshje. Nuk kam folur gjatë kësaj periudhe me trajnerin Panucci, vetëm me stafin e ekipit kombëtar kam qenë në kontakt", ka thënë Grezda për "Telesport".

Medalja "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" për Klubin "Dardania Basel"

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se pjesë e rrugëtimit dhe suksesit të diasporës në Zvicër është edhe Klubi i Futbollit "Dardania Basel" që, pos suksesit në futboll, është shndërruar në adresë që tubon shqiptarët. "Për lartësimin e vlerave të sportit dhe rinisë shqiptare i dhurova Klubit të Futbollit 'Dardania Basel' Medaljen 'Gjergj Kastriotit-Skënderbeu'. Fanellën e Xherdan Shaqirit, të cilën ma dhuroi vëllai i tij, Arianiti, trajneri i klubit, premtova se do ta mbaj gjatë Gjysmëmaratonës së Prishtinës në prill të këtij viti", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Zidane kërkohet nga Juve dhe Chelsea

Me të ardhmen e Massimiliano Allegrit në udhëkryq, Juventusi ka nisur që tani ta kërkojë zëvendësuesin e trajnerit italian. Sytë e bardhezinjve janë te Zinedine Zidane dhe merkatoja e ekipit duket se ka nisur të bëhet në bazë të preferencave të francezit. Pas Ronaldos, sytë e kampionëve të Italisë janë tek Isco dhe Marcelo, lojtarët që i pëlqejnë shumë francezit. Por bardhezinjtë kanë një konkurrencë të madhe edhe nga Chelsea. Maurizo Sarri edhe ai duket se në fund të sezonit do të largohet nga londinezët. Sipas tabloidit "The Sun", flitet se do të ketë një garë të ashpër mes këtyre dy klubeve për Zidanen.

Reali mendon ta shesë Balen

Real Madridi ka humbur durimin me Gareth Bale dhe do të provojë që ta largojë gjatë afatit kalimtar veror, raporton "AS". Përfaqësuesi i Uellsit është lidhur ngushtë me një rikthim në Premierë Ligë dhe Manchester Unitedi, Chelsea dhe Tottenham Hotspur kanë shprehur interesim në të. Pas largimit të Cristiano Ronaldos, ishte pritur nga ai që të dalë si protagonist në "Santiago Bernabeu", por deri më tash ai ka dështuar ta dëshmojë këtë gjë.

25 sportistë aplikojnë për pjesëmarrje në "Minsk 2019"

PRISHTINË, 1 MARS - 25 sportistë të shtatë federatave sportive në Kosovë kanë aplikuar për pjesëmarrje në Lojërat e Dyta Evropiane "Minsk 2019", të cilat mbahen prej 21-30 qershorit në Minsk të Bjellorusisë. Federatat kanë plotësuar aplikacionin e kërkuar nga organizatori, ndërsa Bordi Ekzekutiv i KOK-ut e ka miratuar listën. Data 28 shkurt ka qenë e fundit për dërgimin e listës së gjerë, ndërsa pas një muaji do të vendoset për listën përfundimtare. Federatat që kanë aplikuar janë: xhudoja, karateja, boksi, mundja, pingpongu, shigjetaria dhe çiklizmi. Kosova debutimin në Lojërat Evropiane e ka bërë në "Baku 2015", në të cilat fitoi medaljen e bronztë me xhudisten Nora Gjakova. Në Baku ekipi i Kosovës u përfaqësua me 18 sportistë.

Tetë ekipe ëndërrojnë 'tripletat'

LIVERPOOL, 1 MARS - Në futbollin evropian kanë mbetur aktualisht tetë ekipe të cilat, duke u bazuar në llogaritë matematikore, mund ta finalizojnë në muajin maj sezonin e përkryer. Shumë prej tyre kërkojnë të mbyllin gjithçka me tri trofe, një rezultat i jashtëzakonshëm që, pavarësisht prej koeficentit të ndryshëm të vështirësisë, do t'i ngrejë lart në piedestal.
Manchester United ka më pak mundësi se të gjithë pretendentët e mbetur në garë për "tripletën". "Djajtë e kuq" humbën 0-2 në shtëpi ndaj Paris Saint-Germainit në Ligën e Kampionëve, e në kampionat janë në distancë të madhe me kreun. Ajo çfarë u festua vite më parë me Fergussonin në stol dhe Solskjaerin në fushë, tani duket veçse një ëndërr. Thuajse zero janë edhe mundësitë e Lyonit që në kampionatin francez është 22 pikë pas kryesuesve. Nëse llogaritë bëhen me këtë logjikë, të pakta janë mundësitë për një "tripletë" trofesh edhe nga Ajaxi. Skuadra holandeze ka humbur në shtëpi me Realin e Madridit, ndërsa "galaktikët" u hoqën nga grupi i pretendentëve për "tripletën" pas humbjes me Barcelonën në Kupën e Mbretit. Mbetet kështu një grup prej pesë ekipesh që synon fundin historik.
Paris SG dhe Manchester City kanë hipotekuar kalimin në Ligën e Kampionëve, por nuk dihet si do të ndahen në kampionat. Barcelona dhe Bayern Muncheni duhet të fitojnë në Ligën e Kampionëve, në ndeshjen e kthimit, respektivisht me Lyonin dhe Liverpoolin. E fundit në radhë është Porto, por askush nuk beson se luzitanët do t'ia mbërrijnë në fundin e sezonit me tri trofe.

Orlando mposhti kampionët e Golden States

ORLANDO, 1 MARS - Janë luajtur ndeshjet e radhës në kampionatin më të bukur të basketbollit në glob, NBA. Spikat fitorja e Philadelphias në derbin ndaj Oklahomas, ndërsa kampioni në fuqi, Golden State, është mposhtur nga Orlando. Oklahoma ka triumfuar si skuadër udhëtuese me katër pikë diferencë, me rezultatin 104-108. Thobias Harris realizoi 32 pikë dhe 5 kërcime. Ai ishte më i miri për miqtë, ndërsa Jimmy Butler shtoi 20 pikë të tjera për të tijtë. Russell Westbrook bëri një tjetër "Triple Double", me 23 pikë, 11 kërcime dhe 11 asistime. Kampioni në fuqi, Golden State Warriors, ka vuajtur mungesën e basketbollistit të vet kryesor, Kevin Durant. Për pasojë, ka humbur në parket ndaj Orlando Magicut 103-96. Për këtë të fundit spikati Aaron Gordon që realizoi 22 pikë dhe 15 kërcime.

REZULTATET

Indiana P. - Minnesota T.	122-115
Orlando M. - Golden State W.	103-96
New York K. - Cleveland C.	118-125
Houston R. - Miami H.	121-118
Oklahoma C. - Philadelphia	104-108
Denver Nuggets - Utah J.	104-111

SHKURT

Interi e dëshiron Lewandowskin në vend të Icardit

Drejtuesit e Interit janë duke e përgatitur një ofertë për Bayern Munchun, pasi që italianët e konsiderojnë sulmuesin Robert Lewandowski zëvendësues të përsosur për argjentinasin Mauro Icardin. Lewandowski e kryeson listën e lojtarëve që mund ta zëvendësojnë Icardin në Inter, sipas medieve italiane. Sulmuesi polak ka shënuar 22 gola në 31 ndeshje të këtij sezoni me Bayernin.

Mahrezi lë Cityn për Juven

Riyad Mahrez mund të largohet nga Manchester City për t'u transferuar në Serinë A. Është skuadra e Juventusit që po planifikon transferimin e yllit të Manchester Cityt. "The Sun" raporton se Mahrezi nuk po ka shumë minuta në skuadrën angleze dhe kjo situatë ka bërë që ai ta mendojë largimin në afatin kalimtar të verës.

Sevilla nuk e mendon blerjen e Silvas

Andre Silva u largua verën e vitit të kaluar nga Milani, pasi hapësirat që pati në sezonin e parë me ekipin kuqezi ishin të pakta. Destinacioni i tij ishte Spanja, ku u bashkua me Sevillan në formulën e huazimit, me të drejtë blerje për 35 milionë euro. Nisja ishte fantastike për portugezin, i cili ishte ndër golashënuesit më të mirë në javët e para. Gjithsesi, shkëlqimi i 23-vjeçarit nuk zgjati shumë dhe kohët e fundit duket se nuk po jep rendimentin që pritet. Vetëm dy gola të shënuar në më shumë se 15 ndeshje. Forma që po kalon në muajt e fundit ka bërë që drejtuesit andaluzianë ta rimendojnë blerjen përfundimtare të sulmuesit. Sipas raportimeve të fundit, duket se vendimi që do të marrin për Andre Silvën është që të rikthehet përsëri në Milan.

Unitedi dhe Chelsea në garë për Romagnolin

Manchester Unitedi dhe Chelsea kanë nisur duelin për shërbimet e kapitenit të AC Milan, Alessio Romagnoli. Megjithatë, raportohet se dy klubet angleze do ta kenë konkurrencën e gjigantëve italianë, Juventus, për qendërmbrojtësin. Sipas sajtit italian "calciomercato", Chelsea ka tentuar ta blejë italianin edhe në të shkuarën. Me trajnerin Maurizio Sarri në klub, "The Blues" mund të tentojë përsëri në verë për mbrojtësin që vlen 70 milionë euro. Megjithatë, teksa Chelsea po monitoron situatën, rivalët e Manchester Unitedit thuhet se e duan me çdo kusht Romagnolin, i cili zotëron aftësi të mira teknike.

Sterlingi: City e fiton titullin

Te Liverpooli ka më shumë presion se te Manchester City për ta fituar titullin dhe ky është një faktor që mund ta ndihmojë skuadrën e Guardiolës në këtë sezon. I këtij mendimi është Raheem Sterling i cili ka provuar të luajë me të dyja skuadrat. Vetëm një pikë i ndan dy skuadrat me 10 ndeshje të mbetura në kampionat. "Kemi besim në vetvete dhe kemi mentalitetin e duhur për ta fituar përsëri titullin. Jemi të fokusuar 100 % për të mos bërë asnjë hap fals ndaj kujtdo. Kur isha te Liverpool kisha më tepër presion sesa këtu. Mendoj se tifozët ndikuan te ne. Ishim në kontroll dhe kishim mundësinë, por nuk e shfrytëzuam. Këtu është ndryshe. I marrim ndeshjet një e nga një, por është komplet ndryshe nga viti i kaluar, kur fituam bindshëm kampionatin. Jemi ne ndjekësit dhe gara është shumë e fortë për momentin, por kam besim të plotë te skuadra", ka thënë Sterlingi.

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nr. 01-111-29941
Datë: 01.03.2019

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 3 i Rregullores Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

1. **Titulli i pozitës së punës: Zyrtar i Lartë për Promovim të Kulturës – KRS/440**

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)
Kategoria Funksionale: Niveli profesional 3
Grada e vendit të punës: 8
Koeficienti: 7.5
Lloji i pozitës: Karrierës

Qëllimi i vendit të punës:

Zbaton strategjinë e gjithëmbarshme dhe planin gjithëpërfshirës në segmentin e Kulturës në nivel të Komunës.

Detyrat kryesore:

1. Kryen punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
2. Organizon aktivitetet kulturore dhe punën në ruajtjen, kultivimin dhe prezantimin e vlerave të trashëgimisë së kulturës materiale dhe shpirtërore;
3. Merret me realizimin e manifestimeve kulturore e artistike, shënimin e datave të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare dhe festivaleve tradicionale;
4. Ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
5. Prezanton nevojat për investime kapitale në rehabilitimin dhe ngritjen e infrastrukturës kulturore dhe koordinon punën në realizimin e projekteve;
6. Harton plane për Inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të subjekteve kulturore në nivel lokal;
7. Inkurajon investitorët dhe sponsorët potencialë në përkrahjen e segmentit të kulturës;
8. Kryen edhe detyra tjera që kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkathtësitë e kërkuara:
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e kulturës;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse që i ndihmon procesit të punës;
- Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë ;
- Shkathtësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet:
Diplomë universitare të fakultetit juridik, ekonomik, filozofik, filologjik, informatik, edukimit, i arteve dhe administratë publike, si dhe minimum 3 vite përvojë pune profesionale;

Dokumentacioni i kërkuar:
- Fotokopja e vërtetuar e diplomës (Formati A4);
- Vërtetim mbi përvojën e punës;
- Dy - rekomandime;
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Certifikata e lindjes;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata të ndryshme.

Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më **01.03.2019** deri më datën **15.03.2019** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
Instruksione Aplikimi: Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në http://kk.rks-gov.net/prizren/Shpalljet/Konkurset.aspx, dhe pas plotësimit sipas çdo pike të aplikacionit, i bashkëngjitni dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni tek ne drejtpërdrejtë -Adresa jonë: në sportelin e pranimit nr. 2, në objektin e administratës komunale në Komunën e Prizrenit, rr. "Remzi Ademaj" p.n. -Prizren.
VËMENDJE: Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevoje mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 – 16:00.
Aplikacionet e pranuara pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.
Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen me shkrim (e-mail) në rast të mos konfirmimit të kandidatit në e-mail do të njoftohet me telefon dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit, në rast të mossjelljes të dokumentacionit origjinal intervistues, kandidatët nuk do të mund të vazhdojnë në hapat e mëtejmë të procedurave të rekrutimit.
Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Zyra e Personelit

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

No. 01-111-29941
Tarih: 01.03.2019

03/L-149 sayılı Kosova Cumhuriyeti Sivil Hizmet Yasasın 11. maddesi, 1. fıkrası ve 18.maddesi 3.fıkrası, Sivil Hizmet İstihdam Sürecin 02/2010 sayılı Yönetmeliğin 4. maddesi, 3. fıkrası gereğince Prizren Belediyesi iş bu konkuru ilan etmektedir:

İŞ YERİN DOLDURULMASI İÇİN KONKUR

Kültür, Gençlik ve Spor Müdürlüğü

1. **İş yeri makamı: Kültür Tanıtımı Üst Düzey Yetkilisi – KRS/440**

Çalışan sayısı : 1 (bir)
İşlevsel Kategori : Profesyonel Düzey 3
İşyeri seviyesi : 8
Maaş seviyesi : 7.5
Konum : Kariyer

İşyerin amacı:
Belediye düzeyinde, Kültür alanından tüm kapsamlı stratejiyi ve planı uygular.

Ana görevleri:
1. Sektörün genel çalışmalarını görür ve denetimcisine hedeflerin belirlenmesi ve bu hedeflerin yerine getirilmesi için çalışma planın geliştirilmesine yardımcı olur;
2. Kültürel etkinlikleri ayrıca maddi ve manevi kültürel miras değerlerin korunması, geliştirilmesi ve tanımı çalışmalarını düzenler;
3. Kültürel, sanatsal kutlamaların, ulusal ve uluslararası çapta önemli tarihlerin kaydedilmesi ve geleneksel festivallerin gerçekleşmesi ile ilgilenir;
4. İç süreç ve işlemlerin değerlendirilmesi konusunda denetimcisine yardım eder ve çalışma etkinliği ve kalitesini arttırmak amaçlı değişiklikleri / düzeltmeleri önerir;
5. Kültürel altyapı rehabilitasyonu ve geliştirilmesi için sermayeli yatırım gereksinimlerini tanıtır ve projelerin gerçekleşmesinde çalışmayı koordine eder;
6. Yerel Düzeyde Kültürel oluşumların etkinliklerini teşvik etme ve desteklemek için planlar hazırlar;
7. Kültüre alanının desteklenmesi yönünde yatırımcıları ve sponsorları teşvik eder;
8. Denetimcisinden zaman zaman istenen diğer görevleri de yerine getirir;

Gerekli olan beceriler:
- Kültür alanında içeriksel bilgi ve tecrübe;
- Çalışma sürecini destekleyen iletişim, müzakere ve ikna etme becerisi;
- Hedef belirleme, iş planlaması ve analiz yapabilme becerisi;
- Bilgisayar bilgisi (Word, Excel, Power Point, Access).

Koşullar:
Hukuk, İşletme, Felsefe, Filoloji, Bilgisayar, Eğitim, Sanat ve Kamu Yönetimi fakültesi üniversite mezunu ayrıca en az 3 yıllık profesyonel çalışma tecrübesi.

Gerekli olan belgeler:
- Diplomanın doğrulanmış nüshası (A4 formatında);
- İş tecrübesine ait belge;
- Iki referans
- Ardı adına iki iş değerlendirmesinin nüshası (varsa);
- Doğum belgesi;
- Adli sicil kaydı;
- Kimlik kopyası;
- Değişik belgeler.

Konkur, 01.03.2019 yayımlanma tarihinden 15.03.2019 tarihine kadar yani konkurun kapanışına kadar yayınlandıktan 15 gün sonrasına kadar açık kalacaktır. Bu süre zarfında iletilmeyen ve tamamlanmamış belgeler kabul edilmeyeceklerdir.

Başvuru talimatları: Müracat talebi www.kk.rks-gov.net/prizren/İlanlar/Konkurlar.aspx adresinde bulunmaktadır ve belge başvurunun her bir noktasına göre tamamlandıktan sonra, konkur gereğince talep edilen evraklar da eklenerek doğrudan Prizren " Remzi Ademaj " no'suz caddesi, Prizren Belediyesi yönetim binasının 2 numaralı kabul gişesine müracat edebilir.
DİKKAT: Bildirileri Web'de bulabilirsiniz fakat ihtiyaç duymanız halinde 08:00-16:00 saatleri arasında 038/ 200 44715 telefon numarasından ulaşabilirsiniz.
Belirlenen süre sonrasında kabul edilen başvurular kabul edilmemiş olarak nitelendirilir, eğer posta ileti tarihi ya da herhangi bir başka gönderi tarihi başvuru teslimat süresinden önce gönderildiği kanıtlanır ise.
Koşulları tamamlamayan adaylar yazılı teste davet edilmezler, sadece kısa listeye seçilen adaylar yazılı (e- mail) ya da e- maile cevap vermemesi durumunda telefon aracılığında bilgilendirilecektir ve mülakatçılar, mülakat komisyonun önünde doğrulanması amacıyla eğitim ve kalifiye belgelerin asıllarını yanlarında getirmekle yükümlüdürler aksi takdirde mülakatçı istihdam süreçinden çıkartılacaktır. " Kosova Sivil Hizmeti, Kosova'nın tüm topluluklarından bayan, erkek olmak üzere herkeze hizmet sunmaktadır". Azınlık topluluğu Kosova Cumhuriyetin 03/L-149 numaralı Sivil Hizmet Yasasının 11. Maddesi ve 3. paragrafında belirtildiği gibi merkezi ve yerel kamu yönetimin sivil hizmet birimlerinde adil ve orantılı bir şekilde temsil hakkına sahiptirler.

Personel Dairesi

Republika e Kosovës **Komuna e Prizrenit**
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti **Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Br. 01-111-29941
Dana: 01.03.2019

Na osnovu člana 11 paragraf 1 i člana 18 paragraf 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, člana 4, paragraf 3 Uredbe Br. 02/2010, za Procedure Regrutacije Civilne Službe, Opština Prizren, objavljuje:

KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA

Direktorijat za Kulturu, Omladinu i Sport

1. **Naziv radnog mesta: Viši Službenik za Promociju Kulture – KRS/440**

Broj izvršilaca: 1 (jedan)
Funkcionalna kategorija: Stručni nivo 3
Gradacija radnog mesta: 8
Koeficijenat: 7.5
Vrsta pozicije: Karijere

Cilj radnog mesta:

Sprovodi sveobuhvatnu strategiju i sveobuhvatan plan u segmentu kulture na nivou opštine.

Glavni zadaci:

1. Obavlja celokupan rad sektora i pomaže supervizoru u određivanju ciljeva i odvijanju plana rada za postizanje ovih ciljeva;
2. Organizuje kulturne aktivnosti i posla u očuvanju, kultivaciji i predstavljanju vrednosti nasleđa materijalne i duševne kulture;
3. Bavi se realizacijom kulturnih i umetničkih manifestacija, obeležavanje važnih narodnih i medunarodnih datuma i tradicionalnih festivala;
4. Pomaže supervizoru u procenjivanju unutrašnjih procesa i procedura i preporučuje promene / poboljšanja u cilju povećanja efikasnosti i kvaliteta rada;
5. Predstavlja potrebe za kapitalne investicije u rehabilitaciji i podizanju kulturne infrastrukture i koordinira rad na realizaciji projekata;
6. Razvija planove za podsticanje i podržavanje aktivnosti kulturnih subjekata na lokalnom nivou;
7. Podstiče potencijalne investitore i sponzore u podržavanju segmenta kulture;
8. Izvršava i druge zadatke koji se povremeno traže od strane supervizora.

Tražene sposobnosti:

- Znatno iskustvo i znanje iz oblasti kulture;
- Komunikativne, pregovarajuće i ubedljive veštine koje pomažu u procesu rada;
- Sposobnost u određivanju ciljeva, planiranju rada i analize;
- Kompjuterske veštine aplikacija u programima (Word, Excel, Power Point, Access).

Uslovi:

Univerzitetska diploma prava, ekonomije, filozofije, folologije, informatike, edukacije, umetnosti i javne administracije, kao i minimum 3 godine radnog iskustva.

Tražena dokumentacija:
- Overena kopija diplome (Format A4);
- Potvrda o radnom iskustvu;
- Dve preporuke (ako imate);
- Kopija dva zadnja izveštaja zaredom o proceni rada (ako takvi postoje);
- Izvod rođenih;
- Potvrda da niste pod istragom;
- Kopija lične karte;
- Razni certifikati.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počevši od dana objavljivanja **01.03.2019** do dana **15.03.2019** koji se smatra zadnjim danom zatvaranja konkursa. Dostavljene aplikacije posle predviđenog roka neće se primati i manjkave aplikacije će biti odbijene.
Instrukcije za aplikaciju: Zahtev (Aplikacija) za zapošljavanje nalazi se na http://kk.rks-gov.net/prizren/Shpalljet/Konkurset.aspx, i nakon popunjavanja prema svakoj tački aplikacije, priložite dokumenta koja se traže prema konkursu i možete aplicirati kod nas neposredno – Naša adresa: na šalteru prijema br. 2, u objektu opštinske administracije u Opštini Prizren, ul. "Remzi Ademaj" b.b. -Prizren.
PAŽNJA: Obaveštenja možete naći na Web stranici, a u slučaju potrebe možete kontaktirati tel: 038/200 44715 od 08:00 – 16:00 časova.
Aplikacije primljene nakon određenog roka smatraće se primljenim, ako datum o dostavci zadnjeg dana roka ili bilo kakav drugi dokaz o slanju dokazuje da je ona poslata pre isteka roka za dostavu aplikacije.
Samo kandidati izabrani na užoj listi biće pismeno kontaktirani (e-mail-om) ili u nedostatku potvrđivanja e-mail-om od strane kandidata, biće obavešteni putem telefona i dužni su da ponesu sa sobom originalna dokumenta o kvalifikacijama i izvršenim obukama radi utvrđivanja pred komisijom, u slučaju ne dostavljanja originalne dokumentacije za intervistiranje, kandidati će biti isključeni sa regrutacione procedure.
Civilna Služba Kosova pruža mogućnost zapošljavanja za sve državljane Republike Kosova i dobrodošle su aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica koje žive na Kosovu. Manjinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravednu zastupljenost u organima civilne Službe u Javnoj Administraciji-centralnoj i lokalnoj, kao što je specificirano u članu 11, paragraf 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova.

Kancelarija Personala

Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës

Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/172

Më: 01.03.2019

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS)Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2018/2019

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendesim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" 28 Nëntori" në Kërvasari	Mësimdhënës i lëndës së gjuhës angleze	Zëvendësim i lehonisë me kohe të caktuar	1	20

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal(letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit(ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- Certifikata e lindjes

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të lëndës së gjuhës angleze kërkohet kualifikimet: **Niveli Master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS); sistemi katërvjeçar; Bachelor katërvjeçar(240 ECTS)**, ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve të kualifikuar nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet tjera .

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më**: 01.03.2019 më datën: 15.03.2019**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit,përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

Jaffa
Champion
PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa
Champion

American
Taste
SINCE
1905
RC
cola
RC
Refresher
BITTER
LEMON
Lime
2L

Form. MAP- SHCK-02
Obraz. MJU-CSK-02

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia për Menaxhimin e Kompleksve Memoriale të Kosovës
Agencija sa Upravljanje Memorialni Kompleksa Kosova
Agency on Menagement of Memorial of the Complexes of Kosovo

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Institucioni / AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS(AMKMK), kërkon të punësojë në Zyrën e Drejtorit të AMKMK-së.

Titulli i vendit të punës:
- **Asistent Administrativ 3 - AD/200 / JP00038190 (1 pozitë)**

Departamenti:
- **Zyra e Drejtorit të Agjencisë**

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës:
Niveli Administrativ-Teknik, koeficienti i pagës 6

Numri i referencës së vendit të punës: RN00004408

Detyrat dhe përgjegjësitë:
1. Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimi dhe kopjimin e dokumenteve, plotësimin e raporteve të shpenzimeve , si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
2. Përgatitë dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe e-malit për mbikëqyrësin;
3. Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
4. Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikëqyrësit;
5. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;
6. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

- **Shkollimi i kërkuar:**
- Arsim i mesëm,

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen.
- Së paku tri (3) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative, trajnim përkatës;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim :
1. Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë të veprojnë, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative, si dhe kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse. /

2. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës mund të bëhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit.

Procedurat e konkurrimit:
Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm dhe për nëpunës civilë ekzistues.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:
Përzgjedhja bëhet në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit:
Me afat të pacaktuar – e përhershme (e karrierës)

Afati i konkursit: Është 15 ditë kalendarike nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik

Data e mbylljes së konkursit: 16 / 03 / 2019

Paraqitja e kërkesave:
Aplikacionet merren dhe dorëzohen:
Rr."Zenel Salihu", objekti i ish-Gjykatës Themelore të Prishtinës, kati i II-të, zyra nr. 204, Divizioni për Burime Njerëzore, Agjencia për Menaxhimin e Kompleksve Memoriale ose mund të shkarkohen në ueb-faqen https://amkmk.rks-gov.net,

Kërkesat specifike - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit:
1. Dëshminë e kualifikimit shkollor (diplomat jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i);
2. Dëshmi për përvojën e punës;
3. Dy rekomandime (nëse keni);
4. Kopjet e dy raporteve të fundit, të njëpasnjëshme, të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
5. Dokumenti i identifikimit;
6. **Certifikata që nuk jeni nën hetime;**

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe asaj femërore, nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Emri, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje:

Divizioni për Burime Njerëzore tel: 038-200-10-804.

5 Vite pa më të dashurën tonë

ESHREFE (GUDA) SPAHIU

(18.03.1941 - 01.03.2014)

U bënë 5 (pesë) vite pa ty NËNË, nëna dhe gjyshja jonë e dashur.

Dhimbja nuk shprehet as me fjalë as me lot. Ajo është thellë në brendësinë e shpirtit tonë. Vdekja jote hapi një plagë të madhe tash e 5 vite në zemrat tona, që koha nuk e shëron dot, mungesa jote është zbrazëti që nuk plotësohet kurrë, ndërsa kujtimi dhe malli do të jenë pjesë e jetës tonë.
Të përkujtojmë me mall: Djali Ekremi me bashkëshorten Rahimen, Vajzën Aulonen djalin Auronin si dhe mbarë familja Spahiu nga Muçiverci.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ 'CHE BAR LOUNGE' SHPK me seli në Prishtinë, shpall të humbur certifikatën e regjistrimit me numër: 71169278 dhe numër fiskal: 601268180.

Fetanet Mazrek shpallë te pavlefshme diplomën e gjimnazit "Gjon Buzuku" në Prizren.

▶ "Lulu's coffee and Wine" L.L.C nga Prishtina, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më numër: 601127625.

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv.
Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi im. Eksperienca ime - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 01.03. 2019 deri më 10.03.2019.